





VLADISLAV BAJAC  
**HAMAM BALLKANIA**  
ROMAN DHE TREGIME TË TJERA

---

BOTIMET TOENA

“Botimi i kësaj vepre u mbështet financiarisht nga TRADUKI, një rrjet letrar ku bëjnë pjesë Ministria Federale për Evropë, Integrim dhe Punë të Jashtme e Republikës së Austrisë, Ministria e Jashtme e Republikës Federale të Gjermanisë, Fondacioni zviceran ‘Pro Helvetia’, ‘KulturKontakt Austria’ (ngarkuar nga Zyra e Kancelarit Federal të Republikës së Austrisë), Instituti ‘Goethe’, Agjencia Sllovene e Librit ‘JAK’, Ministria e Kulturës e Republikës së Kroacisë, Departamenti i Kulturës i Qeverisë së Principatës së Lihtenshtajnit, Fondacioni Kulturor i Lihtenshtajnit, Ministria e Kulturës e Republikës së Shqipërisë, Ministria e Kulturës dhe e Informimit e Republikës së Serbisë, Ministria e Kulturës e Republikës së Rumanisë, Ministria e Kulturës e Malit të Zi dhe Fondacioni ‘S. Fischer’”.

traduki™

VLADISLAV BAJAC

**HAMAM BALLKANIA**

roman dhe tregime të tjera

Përktheu nga origjinali serbisht

Ben Andoni

BOTIMET TOENA

Tiranë, 2020

Autori: Vladislav Bajac  
Titulli në origjinal: Hamam Balkanija

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo  
Redaktore: Besa Vila  
Korrektore letrare: Petrina Ago  
Përkujdesja grafike dhe kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 978-9928-327-14-7

© i përkthimit: S. Fischer Foundation me porosi të “TRADUKI”-t.

© Vladisav Bajac

© në shqip Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjete apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

**BOTIMET TOENA**  
Rr. “M. Gjollështa”, K. Postare 1420, Tiranë  
Tel.: + 355 4 22 40 116  
Email: redaksia@toena.com.al  
botimet.toena@gmail.com  
www.toena.com.al

Të gjithë emrat në këtë libër janë të trilluar.  
Personazhet gjithashtu, përfshirë edhe karakterin e vetë  
autorit të gjithëdijsëm.





## PËRMBAJTJA

Hamami ose zotësia e të jetuarit.....	12
Para Fillimit .....	17
Fundi .....	26
Fillimi i vërtetë.....	29
Përpara fundit të vërtetë .....	33
Pas fillimit .....	35
Përpara fundit.....	41
Kapitulli 1 .....	47
<i>Kapitulli I</i> .....	50
Kapitulli 2 .....	54
<i>Kapitulli II</i> .....	57
Kapitulli 3 .....	63
<i>Kapitulli III</i> .....	66
Kapitulli 4 .....	68
<i>Kapitulli IV</i> .....	71
Kapitulli 5 .....	74
<i>Kapitulli V</i> .....	79
Kapitulli 6 .....	82
<i>Kapitulli VI</i> .....	94
Kapitulli 7 .....	104
<i>Kapitulli VII</i> .....	110
Kapitulli 8 .....	119
<i>Kapitulli VIII</i> .....	124
Kapitulli 9 .....	132
<i>Kapitulli IX</i> .....	136
Kapitulli 10 .....	148
<i>Kapitulli X</i> .....	155

Kapitulli 11 .....	166
<i>Kapitulli XI</i> .....	173
Kapitulli 12 .....	181
<i>Kapitulli XII</i> .....	188
Kapitulli 13 .....	191
<i>Kapitulli XIII</i> .....	197
Kapitulli 14 .....	203
<i>Kapitulli XIV</i> .....	208
Kapitulli 15 .....	215
<i>Kapitulli XV</i> .....	222
Kapitulli 16 .....	227
<i>Kapitulli XVI</i> .....	230
Kapitulli 17 .....	233
<i>Kapitulli XVII</i> .....	236
Kapitulli 18 .....	240
<i>Kapitulli XVIII</i> .....	247
Kapitulli 19 .....	252
<i>Kapitulli XIX</i> .....	256
Kapitulli 20 .....	262
<i>Kapitulli XX</i> .....	272
Kapitulli 21 .....	277
<i>Kapitulli XXI</i> .....	282
Kapitulli 22 .....	288
<i>Kapitulli XXII</i> .....	297
Kapitulli 23 .....	302
<i>Kapitulli XXIII</i> .....	310
Kapitulli 24 .....	319
<i>Kapitulli XXIV</i> .....	325
Kapitulli 25 .....	333
<i>Kapitulli XXV</i> .....	337
Kapitulli 26 .....	345

<i>Kapitulli XXVI</i> .....	351
Kapitulli 27 .....	362
<i>Kapitulli XXVII</i> .....	367
Kapitulli 28 .....	375
<i>Kapitulli XXVIII</i> .....	384
Kapitulli 29 .....	394
<i>Kapitulli XXIX</i> .....	404
Kapitulli 30 .....	419
<i>Kapitulli XXX</i> .....	429
Pas Fundit (Uji).....	436
Fundi i fundit.....	447



## HAMAMI OSE ZOTËSIA E TË JETUARIT

Ka shumë të ngjarë që shprehja e mirënjohur “mrekulli e natyrës” të jetë e sajuar nga vetë filozofi materialist grek, Epikuri (341-270 p.e.s.). Dhe ja pse: ai e mbështet etikën e vet dhe lumturinë njerëzore në bindjen se “pa njohjen e natyrës s’mund të arrihet deri te drita e kënaqësisë”. Sipas tij, e mira më e madhe është kënaqësia e lumturisë. Këto postulate, për t’i pasur si qëllim, s’mund të lidhen me dëfrimet vulgare të të shfrenuarve, e aq më pak me nginjen e tepruar gastronomike, si mendojnë profanët për të, por para së gjithash, kjo do të thoshte shmangie e vuajtjes trupore dhe e ankthit shpirtëror.

Arritja e paqes shpirtërore mbështetet mbi bazat natyraliste dhe individualiste.

Besimi i Epikurit në hedonizëm ishte aq i thukët, saqë nuk mundën ta tronditnin as ditët e errëta të shpërbërjes së Perandorisë së Aleksandrit (për fuqinë dhe madhështinë e së cilës ishte dëshmitar edhe vetë Epikuri), pasojat e së cilës ishin gjithçka, veç kënaqësisë. Pavarësisht kësaj, ai mendonte se “nuk ka fare vlerë fjala e një filozofi, që nuk shëron qoftë edhe një vuajtje njerëzore. Ngaqë, ashtu siç është e padobishme mjekësia, që nuk është në gjendje ta largojë sëmundjen nga trupi, po aq e padobishme është edhe filozofia që nuk ia arrin t’ia dëbojë vuajtjen shpirtit”.

Pra, ai që ka ditur t'i shmanget dhimbjes trupore dhe çrregullimit shpirtëror, ai që vlerën më të madhe të jetës e jep për kënaqësinë e ndjenjave dhe për gëzimin shpirtëror (si një të tërë), ai, domethënë, ka njohur aftësinë e të jetuarit dhe të tillë njerëz i takojnë vëllazërisë epikuriane - që ruhet edhe sot e gjithë ditën.

Ati i tij shpirtëror ishte Aristipi<sup>1</sup> (435-355 p.e.s.), themeluesi i Shkollës Kirenaike, i lindur në Kirenë, vendbanimi më i bukur dhe më i përparuar helenik në Libi. Pindari e përshkruan vendin si një kodrinë me pozicion të mrekullueshëm, përplot me burime uji, me të cilat vaditeshin artificialisht kopshtet mbi tarracat e saj. Rrethinën e saj të mrekullueshme e zbukuronin plantacionet e ullinjve, vreshtave dhe koprës së famshme, si dhe livadhet e gjera mbushur përplot me dele, dhi dhe kuaj, prej të cilëve ishte krijuar raca e njohur arabe. Kirenianët kishin zhvilluar një tregti të përparuar, paçka betejave të ashpra me egjiptianët dhe libianët, gjë që e bëri vendlindjen e tyre njërën nga shtetet më të pasura helenike. Ndaj, qytetarëve të tij nuk u duhej t'i harxhonin të gjitha energjitë vetëm në punë, sepse ata u aftësuan si njohës të luksit dhe të kënaqësisë “që vinte nga bollëku dhe kuptimi shumë i rafinuar i jetës”. Vendi dukej si prototip për qytet-shtetet utopike e, para së gjithash, për shoqëritë e Tomas Murit<sup>2</sup> dhe Tomaso Kampanelas<sup>3</sup>.

---

<sup>1</sup> Themeluesi i Shkollës Kirenaike (shën. i përç.).

<sup>2</sup> Sir Thomas More (1478-1535) ka qenë jurist, filozof social, autor dhe burrë shteti britanik, i cili ka shkruar për konceptin e Utopisë (shën. i përç.).

<sup>3</sup> Tommaso Campanella (1568-1639), pagëzuar Giovanni Domenico Campanella, ka qenë i njohur si filozof, teolog, astrolog dhe poet italian (shën. i përç.).

Ndaj nuk përbën aspak çudi fakti që Aristipi, mendimtari, që kënaqësinë e shpalli si parimin kryesor të jetës, të lindte mu pikërisht në Kirenë. Mirëpo, mbeti edhe më i njohur si krijuesi i saj, por me një emër tjetër: hedonizmi. Ai e shpalli kënaqësinë si të mirën e vetme, po ashtu siç e vlerësoi, nga ana tjetër, dhimbjen si të keqen e vetme. Ndjenja e kënaqësisë, pretendonte, shprehet në lëvizje: “Lëvizja e qetë e ndjenjës, pikërisht si fladi i përshtatshëm për lundrën, është burimi i kënaqësisë; lëvizja e ashpër e ndjenjës, sak si stuhia në det, është burim i pakënaqësisë; mungesa e lëvizjes së ndjenjës, e ngjashme me qetësinë në det, është burimi i apatisë, në mënyrë të barabartë si për kënaqësinë dhe për pakënaqësinë”. Megjithatë, Aristipi, askurrë nuk besoi se njeriu mund t’i nënshtrohet tërësisht gjahut për kënaqësinë momentale të ndjenjave; përkundrazi, ai na mësoi se njeriu i ditur, i udhëhequr nga arsyeja, nuk iu nënshtrohet kënaqësive, por përkundrazi, arrin dhe t’i kontrollojë ato. Ai e provoi këtë qëndrim me lidhjen aspak indiferente ndaj *Laisës*<sup>1</sup> hetera dhe me mendimin më të njohur të tij: “Unë e kam Laisën, por ajo s’më ka dot mua”.

Shumë afër me këtë qëndrim ishte drejtimi etik i eudemonizmit (sipas perëndeshës greke të lumturisë dhe fatit), që e konsideronte si motiv kryesor lumturinë dhe fatin, nxitje dhe synim i të gjitha shpresave tona. Por, të gjitha llojet e hedonizmit, që nga sensualiteti i egër deri te shpirtërorja racionale, kanë të përbashkët individualizmin e theksuar ashpër.

---

<sup>1</sup> Laisa e Korintit ishte një kurtizane në Greqinë Antike, e cila ka të ngjarë të ketë lindur në Korint, ka të ngjarë sipas vetë emrit (shën. i përk.).

Historia e ardhshme, e krijuar pas këtyre “shkollave helene të kënaqësisë”, tregon se disa nga krijuesit e saj të rëndësishëm dhe të përmendur, bashkë me shumë individë të tjerë anonimë dhe të pashënuar në histori, në të tërë vrazhdësinë e jetës dhe atë të jetës së popujve dhe shteteve të tyre, tentuan që pjesërisht të gëzonin dhe të mbeteshin të njohur. Ata u përpoqën ta ndiejnë jashtëzakonisht kënaqësinë, deri edhe në diapazonin më të gjerë dhe absurd të të kuptuarit të hedonizmit, si ndjenjë e kënaqësisë në bukurinë e vet ose të huaj, apo qoftë edhe në vdekjen e tyre a të të tjerëve.

E, në mos për gjë tjetër, provuan vazhdueshmërinë e rolit të relativizmit etik.



## PARA FILLIMIT

Vishegradi, ashtu si çdo vend tjetër, ka jetën e tij të vërtetë. Por, ashtu si pak të tjerë, kishte edhe jetën e tij ndryshe. Përvoja ime me metafizikën e Vishegradit filloi në prillin e vitit 1977, teksa duke iu afruar qytetit, para se sa të shihja për herë të parë urën mbi Drinë, që kuptohet e fiksoi përgjithmonë vendin e qytetit në histori. Në fletoren time të poezisë *haiku*, që e ruaj ende sot e kësaj dite, kam shënuar pranë poezisë një koment gjeopoetik “mbi zallin e Vishegradit”, që atë çast po e sodisja tej dritares së autobusit:

*Një gur në mes  
dy bredhë shtegun  
bëjnë në pyll.*

Mikpritësi dhe shoku im prej ditëve studentore, Zharko Çigoja, mendonte se ura e Mehmed pashë Sokolit (Sokollu - ashtu si shkruhet në turqisht) e vitit 1571 - sak ura për të cilën shkroi Andriqi - mjaftonte për çmimin dhe kënaqësinë me këtë rast, kështu që as m'i tregoi atraksionet e tjera të qytetit të tij. Veçse nuk mund ta imagjinonte se sa egoist isha unë, në të vërtetë disi edhe i pezmatuar, ngaqë do të më duhej ta ndaja këtë urë të madhërishtme edhe me të tjerët. Por, si mund të supozoja që hyrja, në thellësinë e sekreteve të Vishegradit, duhej të përftohej nga përvojat e mëvonshme, në bazë të të cilave do më duhej të kuptoja se

mjaftonte të kënaqesha me atë që më ishte ofruar? Sërish, këtu flitej për një vëllazëri sekrete. M'u desh të prisja plot njëzet e gjashtë vjet që të hyja në këtë vëllazëri! Ia vlejti veçse. Ishte pikërisht Ivo Andriqi, i cili më mësoi se si të prisja - duke lexuar kryeveprën e tij, sërish; gjatë studimeve të letërsisë, ende nuk isha në gjendje ta lidhja letërsinë me jetën: aq me shpërfillje kalova përmbi të dhënat e tij mbi fillimin e ndërtimit të urës - mbi vetë thelbin e saj - mbi "prurjen e gurëve nga gurorja e hapur në malet pranë Banjës, gati një orë ecje nga kasabaja". Për më tepër, dy urat më të rëndësishme, së paku për letërsinë - kjo në Drinë dhe ajo në Zhepë - ishin ndërtuar prej të njëjtit gur të bardhë, përmendur te poezia ime *haiku*: me dashurinë dhe paratë e (serbëve të turqizuar a të islamizuar) Mehmed pashë Sokoloviqit dhe Jusuf Ibrahimit, të përjetësuar nga fjalët e ndjera dhe modeste të Andriqit, njeriut që heroit të vet i veshi moton jetësore: *Në heshtje gjendet siguria*.

Kur iu ankova mikut tim se ndoshta krijimtaria ime ishte shterpëruar, m'u përgjigj të mos shqetësohesha. Ai kishte një kurë të vërtetë për këtë sëmundje. Ja, pikërisht do t'i vinte për vizitë shkrimtari turk, Orhan Pamuk, me të njëjtën diagnozë, e kështu të dy së bashku mund të shëroheshim me recetat e tij.

Veç asaj që dija rreth Banjës, llixhave të Sokoloviqit, apo llixhave të Vishegradit, siç i quanin të gjithë, ishte që përveçse vendi i gjetjes së shtufit, me të cilin ishte ndërtuar ura e Vishegradit, edhe fakti se vetëm pesë kilometra larg varoshit<sup>1</sup> gjendej një burim mjekues. Bash atje, në ditët e tij të shkuara të pleqërisë, më 1575, Mehmed Pasha ndërtoi

---

<sup>1</sup> Qytezës (strukturë osmane urbane) (shën. i përk.).

një hamam me kube, duke dashur t'i jepte (edhe) diçka tjetër vendit të lindjes. Në një broshurë të vitit 1934, kisha lexuar se ujërat radioaktive (në lartësinë katërqind metra mbi nivelin e detit) shëronin reumatizmin, neuralgjinë dhe sëmundjet e femrave. Në të thuhej se ujërat e llixhave ndikonin veçanërisht mirë te gratë shterpa. “Kur një grua shterpë futej në llixha dhe pastaj arrinte të lindte fëmijën, i gjithë fshati i mbathur përplot besëtytni do t'ia prekte kokën duke i thënë: ‘Për atë Zot, po të mos shkonte në llixha, dhe të mos i nënshtrohej magjisë, askurrë s’do të kishte pasur fëmijë...’”.

Kështu edhe unë u nisa përmes pyllit të dendur drejt hamamit, nëpër barin e rrallë që rritet vetëm këtu dhe që ata e quajnë *Floku i Zanës*. Më lumturonte takimi me mikun tim të vjetër, Orhan Pamukun, autorin më të famshëm turk nga Stambolli. U habita pakëz se ai, po njësoj, vuante nga bllokimi, edhe pse njihej për krijimtari të bollshme. Nëse rastësisht në ndonjë periudhë të caktuar të jetës së tij si shkrimtar nuk do të botonte për njëfarë kohe, dihej se libri i radhës do të ishte një foshnjë vërtet e shëndetshme.

Unë linda më rrallë fëmijë dhe, më shpesh syresh, nga ata të peshës së mesme. E po i tillë ishte ritmi im. Megjithatë, këto vitet e fundit, unë s’kisha ngjizur as edhe një, ndaj isha seriozisht i shqetësuar. Kjo ishte arsyeja pse shkova të këqyrja gurët që i dhanë jetë ujit: pikërisht pjelloria e tyre ma ktheu besimin. Guri, në të cilin isha ngjitur, ishte lëmuar prej gati më shumë se katër shekujsh! Guri ishte në ngjyrat e barit dhe të myshkut! Uji, i nxehtë, por jo i valë, tamam si ai i ngrohtësisë së parajsës. Kështu trupi im u shndërrua në shpirt! I gjallë, por i vdekur! Pamukut dhe mikpritësit tonë, të cilët përpiqeshin të flisnin përmes mjegullës së ujit, fjalët

u mbeteshin në xhamin e dritares së kubesë dhe humbitnin çdolloj kuptimi të tyre. Ne u kthyem në heronjtë (majmunë) e filmit me titullin *Sufi: Baraka*, e regjisorit Ron Frik, që duke qëndruar në një vend lundronim përgjatë sipërfaqes, e cila shndërrohej në mjegull dhe kalonte pastaj drejt një gjendjeje tjetër të përmbledhur, duke tërhequr me vete të gjitha format e intelektualizmit. Qepallat tona mbylleshin, por sytë nuk na çonin drejt gjumit. Kur kjo kërcënoi të ndodhte, bëra udhë përmes ujit të fuqishëm, për të qenë nën një shtjellë të rëndë, e cila avitej nga malet e mbartej drejt e në basenin e vogël, tashmë përgjatë kurrizit tim. U godita sikundër s'më kishte ndodhur asnjëherë më parë. Por edhe u lumturova deri në marrëzi. Këtu takoheshin kabala, zeni, sufizmi, asketizmi ortodoks, eliminimi katolik prej frikës së mëkatit, islami artistik... Ashtu si fieri i *Flokut të Zanës*, që nuk mund të rritet askund tjetër, edhe uji, vetëm këtu, arrin nga thellësia prej njëqind e tetëdhjetë metrave, madje edhe nga një thellësi edhe më e rëndësishme historike prej asaj e tridhjetë e tetë mijë vjetësh. Një moshë e mjaftueshme për të mos dyshuar në arsyen e ekzistencës së tij apo që t'i drejtohet botës.

Prej këtu vinte edhe komunikimi im me të shkuarën. Lashtësia e frymuar këtu është krejtësisht autentike dhe nuk mund t'i rezistohet aq lehtë. Shpirti fillimisht humbet orientimin e tij, e pastaj edhe nocionin e kohës, më vonë edhe trupi humbet orientimin e tij - e pastaj shuhet edhe nocioni i hapësirës. Kjo nirvanë e pazakontë më shndërroi në një pikëpyetje të madhe: A mos vallë grave shterpa në këtë banjë, u shërbente ndonjë burrë i njohur për farën e tij të shëndetshme? A mos ishte vallë kjo banjë një harem meshkujsh për gratë e dëshpëruara shterpa? E çfarë

kënaqësie do të kishte qenë ky basen i fshehur për bejlerët, pashallarët, vezirët e sulltanit pavarësisht nëse ishin ata mikpritës, apo të ftuar! Cilado qoftë gjinia, që shërbente në këto ujëra aktive, si edhe njerëzit që laheshin aty, thonë se, shkruhet në një tekst të humbur, ajo dashuri e bërë nën shtjellat e malit (në temperaturën prej 34 gradësh) ishte baras me kënaqësinë në bukuritë e kopshteve qiellore të Valhallës<sup>1</sup> dhe Xhanës<sup>2</sup>.

Ky hamam mund të kishte qenë vend ideal për një karvan-saraj. Sa pará do të kishin lënë vallë atje udhëtarët?! Mirëpo, natyra (por edhe fati) desh ta fshihte atë nga rrugët me qarkullim të madh dhe e vendosi në një lartësi, që e shkurajon udhëtarin e lodhur, qoftë edhe nga mendimet më të zakonshme për ta pushtuar. Për këtë arsye gurët e hamamit i kishin lëmuar dekadat dhe shekujt më shumë sesa vetë dora e njeriut.

Edhe pse duhet pranuar se kjo dorë ishte futur ngado dhe kurdo kishte pasur mundësi. Ndaj mund të gjenden citime në dorëshkrimet e vjetra (të njohura për nga gjuha e tyre, por pa qenë e nevojshme të shënohet burimi dhe data e tyre), të cilat përputhen me të tashmen: “Pranë llixhës ishte ngritur ndërtesa, ku një investitor i njohur mbante restorantin dhe dhomat për bujtje. Para kësaj ndërtese gjendej një verandë e madhe, prej nga ku hapej panorama e mrekullueshme e natyrës”.

---

<sup>1</sup> Valhalla. Në mitologjinë e vjetër norvegjeze, shpirtrat e luftëtarëve që vdisnin fisnikërisht në betejë, zgjidheshin nga Odini, të vinin në këtë vend, një pallat madhështor, ku kalonin ditët post-mortum në një lloj parajse (shën. i përk.).

<sup>2</sup> Jannah-Stadi i parë i purgatorit islam ose Daru-el-Bawar. Nga kjo vjen termi biblik Gehenna (shën. i përk.).

Unë nuk e di sa i njohur është investitori i tashëm, qoftë privat apo jo, por ai nuk kishte hequr dorë qoftë nga “restoranti”, qoftë edhe nga “veranda”. Pasi, është e vërtetë, se kënaqësia e banjës në basenin e vockël të parajsës, nuk do të ishte kurrë e plotë, sikur pas kësaj të mos kalohej përmes njëfarë gjysmë ure drejt e mu në verandën e restorantit. Ajo është, në fakt, një ballkon i madh, i varur, pa xhama, mbi një shkëmb të thellë malor, ku mendimet të shpërhapen drejt pamjes së tij të mrekullueshme, për të cilat nuk jeni më të bindur se, ashtu të reflektuara nga kodrat dhe lugnjat e Bosnjës, që qëndrojnë krah jush, do t’u kthehen shterpë. Po ushqimi! Pranë të gjitha mezeve shtëpiake, do t’ju presë gjithnjë një troftë e freskët, e saponxjerrë nga diku aty afër, porositur me telefon në Zllatibor, vetëm një orë më parë. Ishte pikërisht ajo që i ka mbijetuar dimrit pa ushqim dhe posa kishte filluar të ushqejej me ushqimin e pandotur.

Megjithatë, struktura moderne e këtij restoranti, nuk duhet ngatërruar me karvan-sarajin e shekullit XVI. Kjo, kurrësi nuk është. Sot, për ata që dëshirojnë të kënaqen pak më gjatë në këtë bukuri, pakëz më larg gjendet edhe hoteli - qendra e rehabilitimit, e quajtur *Floku i Zanës*, me tërë komfortin e nevojshëm, por edhe me një basen modern, ku natyrisht nuk mungojnë ujërat termale. Bartësi i radioaktivitetit të tyre është radoni, e atje ku është radoni, domosdo do të gjenden edhe doktorët, edhe fizioterapistët. Natyrisht që s’është e nevojshme të jeni të sëmurë, apo thjesht të doni të kujdeseni për shëndetin tuaj për të ardhur në këtë vend. Pikërisht ashtu, duke ardhur këtu i shëndoshë, ju i provonit vetes se nuk jeni i çliruar ende nga hedonizmi.

As Mehmed pashë Sokoloviqi, nuk e ndërtoi hamamin e karvan-sarajit nga “Ilixha e mrekullueshme me kube”, por

veçse e goditi pak më poshtë, “pranë lumit Drina, si hani i gurtë i Sokoloviqit, apo karvan-saraji, i cili mund të strehonte plot dhjetë mijë kuaj dhe deve nën çatinë e tij”. Mendoni vallë se numrat janë të ekzagjeruar? Nuk do ta thosha këtë. Edhe nëse do të ishin të tepruara, nuk do të ishin larg së vërtetës. Vetëm imagjinojeni se çfarë ndërmarrjeje duhej të ishte ndërtimi i një ure si ajo e Vishegradit në vitet shtatëdhjetë të shekullit të gjashtëmbëdhjetë! Në kohën e Mehmed Pashës, Vishegradi kishte rreth shtatëqind shtëpi, një xhami të quajtur Selimie dhe çezmat, rreth treqind dyqane, një imaret që ushqente vendasit e varfër dhe një manastir dervishësh - një teqe. Në fshatin Sokoloviq (që e mori emrin prej pashait, apo ndoshta vetë pashai e mori emrin prej tij, kjo s’ka rëndësi) ndodhej xhamia e Sokoloviqit, por edhe vendi për kishë, ku, sipas legjendës, pashai ndërtoi tempullin e nënës së vet ortodokse. Kjo, natyrisht, nuk duhet të çuditë askënd, sepse shumica e njerëzve e dinë se ishte pikërisht Mehmed pashë Sokoloviqi, vezir i Divanit Turk, që më 1557 e rinovoi personalisht Patriarkanën serbe në Pejë dhe në krye të saj vendosi të vëllanë, Makarien, në momentin kur si na pohojnë burimet “Ortodoksizmi ishte në kaos dhe drejt shkatërrimit, ndërsa ideja kombëtare e popullit serb kishte filluar të venitej nën vargonjtë e rëndë të skllavërisë”. Disa historianë mbështesin mendimin se “veziri i madh, përmes këtij akti, e ruajti popullin serb nga zhdukja dhe shkatërrimi përfundimtar”. Kjo nuk mund të jetë aq larg nga e vërteta, nëse dihet se sa rëndësi i jepte populli serb në atë kohë, duke mos pasur shtetin e vet, zëvendësimit të shtetësisë - me kishën. Kjo është edhe arsyeja për cilësimin jetëgjatë ndaj Mehmed pashë Sokoloviqit, si “një mysliman i patundur, por në të njëjtën kohë... një patriot i mirë, që ia

shpërbleu me dinjitet popullit të vet”. Ai besonte se kështu pajtoi islamin me atdheun e tij boshnjak, rrënjët e tij serbe dhe fenë e krishterë ortodokse.

Ja pse (mendoj unë) këtu në hamam mbërriti me mua shkrimtari më i mirë, më i njohur, por njëkohësisht dhe aq i përfolur, bashkëkohori turk Orhan Pamuk - ngaqë, nëse ka ideologji në romanologji, ai patjetër ia ka dedikuar librat e tij lidhjeve mes Lindjes dhe Perëndimit, e kështu vazhdon udhën që kanë ndjekur disa nga paraardhësit e tij. Unë pata rastin të bindesha për këtë në bisedat me Pamukun dhe jo vetëm e thjesht duke lexuar librat e tij aq të shquar. Dhe një arsye tjetër akoma. Kryevepra e tij, romani “Unë jam e kuqja” lidhet me Perandorinë Osmane (pjesërisht edhe me kohën e Mehmed Pashës, si dhe me pasojat e asaj kohe), më ka njohur me lidhjet e rëndësishme të sistemit turk - sundimit pushtues dhe pushtimit të territoreve të reja, për artin brenda Perandorisë, për ato gjëra ku pothuaj nuk dija asgjë. Për mundin e tij dhe për të mirën e të tjerëve, Pamuku e meritonte një banjë virtuale (për të ndoshta dervishore). Meqë ra fjala, pastërtia dhe dëlirja kurrë nuk ishin të mjafta. Por as zbavitja apo akshamlluku, “zakoni boshnjak që para mbrëmjes të uleshe mbi bar, zakonisht pranë ujit, duke pirë raki, shoqëruar me këngë dhe muhabet”.

Po, çfarë shkrimtarësh do të ishim, sikur ndonjëherë kaq pranë hamamit, të mos bënim ndonjë akshamlluk? Me kusht që këtë fjalë ta kuptojmë njëkohësisht edhe në mënyrë hedoniste, edhe në mënyrë filozofike.

Problemi i shkrimtarit, njëri prej të shumtëve, është se shpesh e ngatërron realitetin me imagjinatën. Prej kësaj na vjen edhe ajo shlyerja e famshme e kufijve ndërmjet të ndodhurit dhe të përjetuarit. Kështu fillova t’i përziej



kohësisht takimet e mia me njerëzit e mi të afërt, dua të them, ata që jetuan pesë shekuj para meje, i afrova drejt kohës sime, ndërsa veten dhe miqtë e mi (ose personazhet, njësoj është) i transferova me lehtësi në jetë me shekuj më të vjetër se shekujt tanë. Ndaj mund të ndodhë që takimet tona reale dhe irracionale të shpeshtohen.

Kjo ishte njëra nga mënyrat e përmbushjes së ëndrrës së shkrintarit rreth plotfuqishmërisë kohore të fjalës.

Për shkak të kësaj ëndrre, mes të tjerave, krijohen edhe librat.

## FUNDI

Do të dëshironte që dikush ta vriste. Po, tamam kështu. Më thjesht - të vritej. Në vitin e fundit, shumë gjëra për të cilat ishte kujdesur aq shumë në të gjallë dhe i deshi, tashmë ishin larguar tërësisht nga jeta e tij. Natyrisht, jo rastësisht. Të gjitha ishin planifikuar me shumë kujdes dhe po ashtu ishin zbatuar. Duhej të pohonte - se kundërshtari i tij i përmbushi të gjitha pa gabime dhe kështu, nga pikëpamja e zotësisë dhe e aftësisë së asaj që bëri, s'mund të kishte absolutisht asgjë për ta kundërshtuar. Përveç thelbit të mendimit të tij: Pse vallë armiq të vendosën të gjithë makinerinë në lëvizje dhe shpenzuan kaq shumë kohë, pará, energji, me qëllim për të shuar çdo gjë të dashur për ta, kur mund të ishte më e shpejtë, më e lirë dhe më e lehtë për ta vrarë drejtpërdrejt dhe thjesht vetëm atë?

E, në fakt, e dinte. Ajo, që ata vërtet donin, ishte që ai të bënte të njëjtën pyetje dhe të mos gjente përgjigje, dhe në fund të ndihej kaq i vetmuar dhe, mbi të gjitha, të sikterisej aq sa edhe vetë të mos dëshironte të jetonte më. Pasi arriti të shohë nga afër se si më të dashurit, ata më besnikët, i zhdukeshin një nga një para syve, e kishin lënduar e kështu po shkonte tej e më tej. Nëse do ta *kishin vrarë atë të parin dhe menjëherë*, atëherë ai s'do të kalonte asnjë nga vuajtjet që ata donin, dhe për të cilat ata u kujdesën t'i kalonte. Pa dyshim, pas kaq shumë dekadash me pushtet, e bash në majë, atij i duhej ta priste këtë rënie, apo ndonjë gjë tjetër të njëjtë. Kështu ka qenë, prej fillimit të botës; ngritja është më së shumti e shoqëruar me rënie. Kushdo që arrinte

majën, duhet të ishte po ashtu edhe në fund. Megjithatë, jo çdokush shkonte përgjatë së njëjtës rrjedhë të ngjarjeve. Në të vërtetë, kushdo qoftë ai që do të ishte në majë, domosdoshmërisht duhet të shikojë edhe fundin. Por nëse çdokujt i duhej të binte poshtë, pasi kishte qenë në majë, kjo mbetej plotësisht e diskutueshme. Atij iu këput filli. Apo do të ishte si thoshin ata, e shkruar qysh më parë. Apo ndoshta e ndolli vetë rënien e tij.

Të themi të vërtetën, rënia e tij ishte disi e drejtpërdrejtë. Askush nuk e zëvendësoi, e hodhi poshtë, apo e shmangu me ndonjë autoritet të ri (që nuk do të thotë se të gjitha këto ngjarje nuk ishin planifikuar). Ai u rrëzua poshtë fill me gjuajtjen e parë, një goditje e fortë e thikës mu drejt zemrës dhe tashmë gjendej i shtrirë në një pellg gjaku, duke e vëzhguar krejt jetën e tij të shkuar, njësoj sikur ta kishte përmbledhur të gjithën para vdekjes, në atë mënyrë që ai kurrë nuk do të mund ta harronte.

Ja, pra, dëshira i ishte përmbushur: ishte i vvarë.

E çuditshme sesi vdekja mund të jetë edhe lehtësim! Në të vërtetë, vrasësit nuk e kishin bërë këtë për t'i treguar keqardhjen. Gjatë sundimit të tij, vdekjet e dhunshme ishin gati për çdo ditë një ngjarje fare e zakonshme; nuancat e tyre ishin vetëm në llojin ose shkallën e morbiditetit apo brutalitetit. Perandoria e kishte nënkuptuar dhunën në të gjitha kohërat dhe format. Për aq kohë sa ai vetë ishte vezir i madh, marrja e jetës së të tjerëve nuk kishte qenë metoda e tij karakteristike si drejtues apo, mos e dhëntë Zoti, veçori e karakterit të tij personal. Ajo ishte pjesë e mbrojtjes së sistemit; s'ishte, të paktën, thjesht çështje e mbrojtjes së autoritetit të tij. Ishte një mekanizëm i ndërtuar ndër shekuj, që nuk e llogariste aspak individin, nuk kish rëndësi se në çfarë pozicioni apo autoriteti ekzistonte, ai duhej të fillonte

të shqetësohej më shumë kur ndodhte qoftë edhe ndryshimi më i vogël sesa kjo. Në beteja, luftëra, fushata dhe pushtime, vdekja ishte po aq e zakonshme, si të thoshe “*Tungjat*”. Ndodhte vazhdimisht edhe në kohë paqeje, por për hir të së vërtetës, jo aq shumë.

Po, vallë, a nuk ishte ai i famshëm si vezir i madh pikërisht për faktin sepse kishte sunduar gjatë mbretërimit të *tre sulltanëve*! Kush tjetër mund të lavdërohej për këtë? Rrallë kishte ndodhur që një vezir të mund t’i mbijetonte mbretërimit të vetëm një sulltani dhe jo tre syresh në radhë, si kishte ndodhur me të! Çdo vdekje vinte nga sunduesi i lartë: a nuk ndodhte vallë që çdo sulltan, sa merrte fronin, me një ligj të pashkruar, e para nga të gjitha, do të vriste fillimisht vëllezërit (disa edhe fëmijët e tyre); kështu që *ata nuk do të mund t’ia kërcënonin dot sundimin?*

Nuk do të ishte e vërtetë, edhe nëse do të thoshim se po e *priste* vdekjen e tij. Thjesht kjo nuk e habiti. Ai dinte gjithçka rreth vdekjes: madje ishte shumë e vështirë të gjeje dikë tjetër që t’ia kalonte në njohuritë rreth shkaqeve dhe efekteve, llojeve dhe tipave të vdekjes. Ndoshta nuk mund t’i linte jashtë pyetjet për dobinë e saj: asnjë nga mësuesit e tij, ose sunduesit, nuk e kishte drejtuar për të tilla të fshehta, sepse çështja e destinacionit mes tyre kurrë nuk mund të vihej në diskutim.

Vdekja e “dëshiruar” s’do të thoshte kurrsesi se ai “mezi po e priste”. Dëshira e lejonte ta priste qetësisht fatin e tij të vërtetë. Ai hoqi të gjitha pavërtetësitë e kota.

Megjithatë, tashmë çdo gjë kishte reshtur së qenë e rëndësishme dhe veçanërisht ajo gjëja, e cila kërkonte kohën shtesë për të reflektuar. Nuk kishte më aq shumë kohë për t’i mbaruar të gjitha gjërat. Përveç vdekjes.

## FILLIMI I VËRTETË

Sapo ia mbusha mendjen vetes (në rrugët e njohura vetëm nga unë) se nuk isha “shterur” si shkrimtar, fillova të luftoja realisht për zgjidhjen e kësaj dileme. *Cilin nga tre librat e planifikuar duhet të filloja të shkruaja më parë?* Nuk dua t’i përmend dy librat e tjerë të parashikuar, sepse i kisha tashmë, por ndjeva se kisha filluar shkrimin e atij që realisht doja. Natyrisht, arsyet më të ndjeshme ishin në favor të këtij libri, pavarësisht se ndërkohë punën më të madhe përgatitore voluminoze dhe atë më serioze e kisha bërë për dy librat e tjerë të ardhshëm, nga një përzgjedhje shumë e ngushtë, punë pa të cilën, unë nuk do të mundja as të filloja të shkruaja.

Prej këtyre arsyeve të rëndësishme, shkallët ishin cekur nga ata që unë me një fjalë do t’i quaja “lokal-patriotike”. Domethënë, nga bisedat e mëparshme me një koleg mbi temat aktuale dhe ekstremite, të tilla si nacionalizmi dhe globalizmi në temat letrare, për të parën herë kuptova faktin se mbrojtësit e zjarrtë të “shtëpiakes” nuk ishin të hapur, dhe ruanin një lloj nënvlerësimi teksa më quanin “kozmpolit”; por edhe këtë e bënin disi me kujdes, aktualisht nën zë (“shkrimtar i njohur, që nuk i përdor temat kombëtare”), gjë e cila në fakt s’ishte e vërtetë. Ishte disi e çuditshme sesi e kisha menaxhuar gjithë atë kohë (deri në momentin e kësaj gjetjeje të pakmëparshme) për të bërë paqe me faktin se të tjerët, ndërkohë, e kishin përcaktuar fatin tim letrar

dhe, madje, deri me konkluzione false për këtë! Dhe, çfarë do të thoshte kjo, nëse ata s'i kishin lexuar fare librat e mi? Apo që ata i kishin lexuar, por unë gjithsesi mbetesh një i ashtuquajtur shkrimtar i palexuar? Kështu, do të ishte e mjaftë për t'i kujtuar ata se në katër nga romanet e mia, nga pesë të botuara deri më tani, aksioni fillon, ose ndodh të paktën, vetëm në Beograd dhe/ose në vendin tim, dhe që nga shtatë librat e mi të prozës (të mos e llogaritim këtë, natyrisht), gjashtë përmbajnë të njëjtën topografi! Turp, për atë të vetmin që s'e ka! Dhe ende, kërkimi i fajit s'mbaron këtu: ndoshta këta libra në esencën, apo mesazhin e tyre janë tejet kozmopolitë, kështu që edhe gjeografia lokale, apo veprimi lokal nuk mund t'i ndihte. Ata nuk ia kishin dalë të ngriheshin në nivelin e mitit kombëtar, i cili, pa dyshim, po ashtu s'është pjesë e konceptimit të tyre.

Tema e zgjedhur fsheh kurthe të reja, jo vetëm sa i përket zejes së shkrimtarisë, por edhe ato të përmendura më parë - ideologjike. Megjithatë, nëse një njeri kujdeset kaq shumë, ka të ngjarë të mos shkruajë më kurrë asgjë (që ia vlen). Kështu, pra, zgjodha për të shkruar rreth një Serbi *që u bë diçka tjetër*. Kjo “diçka tjetër” më interesonte. Madje, jo veçmas ai “Serbi”, edhe pse do ta doja, nuk do të mund ta ndaja nga të Tjerët. Kur do të më duhej vërtet të gërmoja thellë, do të pohoja se isha tani në bazë i interesuar vetëm në ekzistencën e *tranzicionit* nga Njëri drejt Tjetrit, te ky veprim në vetvete.

Kështu fillova të kërkoja, të gjurmoja, të mblidhja, të zgjidhja, të pranoja e pastaj të hidhja... Fjalë, në të ashtuquajturat mbledhje materiale. Por edhe për këtë proces mbledhjeje më duhej akoma të zgjidhja një metodë, ose të paktën një rend hapash, që duhej të hidhja. Faktet, si

një lloj lajtmotivi të procesit, mund të shfaqeshin prej diku dhe pastaj t'u shtoheshin atyre që ekzistonin qysh më parë. Ato shpesh ndërhyjnë tamam kështu, praktikisht gjatë udhës dhe gati rastësisht, sikur automatikisht kërkonin të njiheshin nga autori. Kishte ndërkohë në mes edhe rrugë të tjera, për detaje të tjera të rëndësishme të pazbuluara. Një nga ato rrugë ishte të ndiqje gjurmët e personazheve. Kështu, unë, për disa vite me radhë (paralelisht me rrugët e tjera të studimit të kësaj teme) kalova përmes rajoneve më të rëndësishme, edhe nëse jo në të gjitha ato rajone, në hapësirat ku Mehmed pashë Sokoloviqi kishte qenë apo kishte punuar në të gjallë: Vishegradi me rrethinat e tij dhe me hapësirën e gjerë të Bosnjës Lindore dhe të Serbisë Perëndimore (përfshirë këtu lumin Drina që ndan/dhe i bashkon ato), Hercegovinën me Dubrovnikun, Vojvodina me Hungarinë Qendrore, pjesa e saj perëndimore me qendrën e Perandorisë së Vjetër Austro-Hungareze -Vjenën, të gjithë hapësirën e Bullgarisë (ose më mirë të themi horizontin), ish-kryeqytetin e vjetër të Perandorisë Osmane - Edirnenë, dhe pastaj zemrën - si të kohës së Lashtësisë dhe të asaj Moderne të Bizantit - Kostandinopojën/Carigradin, Stambollin/Istanbulin, ashtu si dhe të gjitha detet e përfshira në këtë hapësirë (detin Adriatik, Detin e Zi, detin Marmara, detin Egje). E mbarova kërkimin tim në jugperëndimin e Turqisë dhe drejt fundit në Ishujt e Princit. E kam përshkruar shumë herë këtë hapësirë. Persia ishte i vetmi vend, i cili mbeti krejt jashtë mbulimit tim. Jam penguar thjesht nga luftërat që zhvilloheshin në rrethinat e Turqisë - sot ajo pjesë e Persisë që nuk ekziston më. Përpara saj, më penguan luftërat rreth Serbisë, atë që sot njihet si Jugosllavia joekzistuese, që të shihja gjërat në oborrin tim (Beogradi, që ishte kaq i rëndësishëm për mua,

është nënkuptuar thjesht si një toponim. Përveç kësaj, e gjithë historia fillonte atje dhe me gjasa shpejt çdo gjë do të mbaronte po ashtu atje).

Një paralele tjetër studimi përmes këtyre udhëtimeve ishin vizitat në mrekullitë arkitekturore të Mimar Koça Sinanit, personazhi i dytë kryesor në librin e ardhshëm, një bashkëkohës i Mehmed Pashës. Unë, po ashtu, vizitova edhe një njeri të quajtur Orhan Pamuk, si dhe V. B., me të cilin kisha ndenjor shpesh. Këta të dy më vonë do të ishin çifti i dytë i aksionit paralel të romanit të planifikuar.

Këta katër njerëz u bënë personazhe në të njëjtin libër (vendosur në fakt në faqet e kundërta), faqe që rekrutoi secilin prej tyre në një konspiracion kundër historisë, kuptohet me aq sa dija unë.



## PËRPARA FUNDIT TË VËRTETË

Përpara vdekjes së tij, natyrisht, kishte pasur dhe jetë. Një jetë të gjatë dhe të pasur. Të fuqishme, por gjithashtu edhe të pasigurt. Jeta e tij ishte si e çdokujt tjetër, nga koha në kohë, pronësia e saj i rrëshqiste nga duart. Nëse do të kishte qenë thjesht punë e vetë Zotit - atij Zotit të Zotave, apo e ndonjë të dërguari të Zotit - zgjidhja mund të kishte qenë e thjeshtë: Muhamedi apo Krishti. Apo të dy në të njëjtën kohë. Megjithatë, dikush, ose ka të ngjarë *diçka*, ia mori jetën rastësisht dhe e la atë vetë pa mundësinë bazë të zgjedhjes se cilës apo se kujt i përkiste.

Ndoshta kjo, në vetvete, s'do të kishte qenë ndonjë enigmë e tillë e pazgjidhshme, nëse s'do t'ia impononte vetes aq shpesh, por dhe vazhdueshëm, gjithnjë e më shumë teksa ai plakej. Madje, edhe tej çdo kuptimi të masës. Që kur nuk ishte më i aftë të gjente arsye logjike, ndihej po aq i paaftë edhe për ta zgjidhur problemin. Dhe, kur Sekretit ishte grumbulluar mbi ngarkesën e kaq shumë viteve, jeta iu kthye realisht në një makth. Kishte të ngjarë që vdekja e tij e afërme (apo ka të ngjarë lakmia e tij) ta kishte një efekt; kundërmimi i saj i afërt mund të ndryshonte pikëpamjen e tij të botës, të pranuar dhe provuar një mijë herë më shumë - ta kthente krejt në të kundërtën e vet dhe ta transformonte pastaj në një të vërtetë të pëshitirë. Por ai vetë nuk arrinte të paktën as edhe këtë! Po mendonte se do të ishte më e lehtë të pranonte edhe më të keqen e të vërtetave, një nga ato pamundësitë e tij dhe të kapej me *ndonjë* prej tyre.

Dy shpjegimet e mundshme, në asnjë mënyrë, s'do t'i merrete në konsideratë.

E para u mor vesh: Ishte dëshira e Allahut! Askush nuk guxon, apo dhe nuk mund ta kundërshtojë. Publikisht. Por që kur ky ishte bashkëbisedim, që e ndrydhte brenda vetes, publikut s'kishte çfarë t'i duhej, madje as edhe vetë Allahut.

Shpjegimi i dytë nuk largohej sërish shumë larg të Plotfuqishmit. Mund të thuhej se ishte vendosur për të: Destini. Këtë nuk mund ta pranonte, sepse ishte një sajim për fuqinë që ta justifikonte dobësinë e njerëzve.

Ai e kishte provuar të vërtetën, oh ironia e saj, teksa tehu i thikës, atë çast iu rras thellë mu në gjoks: ishte vërtet zot i jetës së tij, por *veçse* përgjysmë. *Gjysma* sundohej nga gjysma tjetër e personalitetit të tij. Apo, ndoshta më mirë të thuhet në një rend të duhur, sak ajo pjesa e parë të cilën e kishte pasur në Serbi dhe në Bosnjë.

Ishte turk, po aq sa edhe serb. Dhe serb, edhe turk.

Çfarë lehtësie.

Të vdesësh.

## PAS FILLIMIT

Planifikimi i strukturës së romanit nënkupton ekzistencën e dy fillimeve dhe të dy fundeve, apo dy llojeve të fillimit dhe të mbarimit. Një nga fillimet dhe fundet lidhet vetëm me veprimin: si dhe kur duhej të fillonte, si dhe kur duhej të përfundonte. Ky ishte ndoshta për lexuesin edhe sekreti më i rëndësishëm i librit. Për autorin mund të kishte rëndësi një tjetër sekret, ai që i takon sekretit të fillimit dhe fundit të ideve, që e nxisin vetë autorin. E thënë në mënyrë të saktë: cila ishte pyetja apo problemi, që kishte frymëzuar autorin për librin, dhe që nga kjo ide/problem të fillonte të shkruante, dhe cila ishte ajo ide e dëshirueshme dhe përfundimtare, që do ta çonte librin deri te fundi.

Ndërsa struktura e këtij libri ishte ende për mua disi abstrakte dhe krejt e mjegullt, e dija se personazhet e tij ofronin mundësinë e zgjidhjes së një rrëfimi të thellë rreth identitetit të tyre dhe identiteteve, ashtu si edhe e ndryshimeve të tyre. Kjo mund të kishte qenë dhe e ashtuquajtura pikë e fillimit, ndërsa qëllimi veç mund të hamendësohej: çfarë do të ndodhte te njerëzit dhe tek ata përreth tyre nëse do të kishin një identitet të dyfishtë?

Forca shtytëse e këtij romani, Mehmed pashë Sokoloviqi, më shtyu të shkruaja në emrin tim rreth *shkakut* dhe *arsyes*. (Kujtoj se si na përgatitën në shkollat fillore për logjikën, lëndë e ardhshme në gjimnaz, por gjithashtu edhe për logjikën e jetës dhe në shembujt e dhënë për luftën - si ta

dallonim shkakun nga arsyeja. Shumë nga ne nuk e kapnim, por edhe nëse e kuptonim ajo paraqiste vështirësi të madhe. Megjithatë, ashtu si të tjerët, pas shumë përpjekjeve, e kuptova njëherë e përgjithnjë: shkakun përgatitet gjatë dhe me shumë thellësi, kurse motivi ishte ndalimi dhe mund edhe të përfytyrohej, sepse përbente një levë të zakonshme në një plan, i cili ekzistonte prej kohësh. Shembulli që ata pëlqenin, për të na disiplinuar më së shumti, ishte Lufta e Parë Botërore - princi trashëgimtar i monarkisë Austro-Hungareze, Serbia, Bosnja, Sarajeva, “Dora e zezë”<sup>1</sup> dhe atentatori/patrioti Gavrilo Princip<sup>2</sup>.)

Kështu, *arsyeja* që të punoja me Bajica (Bajo) Sokoloviqin lidhej me zbulimin se në të mirënjohurin “haraçi i gjakut”, ai u çua në Turqi, kur ishte të paktën tetëmbëdhjetë vjeç (!), dhe jo fëmijë i vogël, që mezi do të ishte i aftë të kujtonte se nga vinte. Pyeta pastaj sesi ishte e mundur që u zgjodh për të qenë jeniçer, kur ai ishte aq i

---

<sup>1</sup> Unifikimi ose Vdekja (Serbisht: Уједињење или смрт / Ujedinjenje ili smrt), që u njoh gjerësisht si “Dora e Zezë” (Црна рука / Crna ruka), ishte një shoqëri ushtarake sekrete e formuar në 1901 nga oficerët në Ushtrinë e Mbretërisë së Serbisë, e njohur për dyshimin se organizuan vrasjen e Arqidukës Franz Ferdinand në Sarajevë dhe për komplotin e mëparshëm për vrasjen e çiftit mbretëror serb në 1903, nën kujdesin e kapitenit Dragutin Dimitrijević (me emrin “Apis”) (shën. i përk.).

<sup>2</sup> Gavrilo Princip (25 korrik 1894 - 28 prill 1918) ishte anëtar i kryesor serb i organizatës “Boshnjakët e Rinj”, që kërkoi t’i jepej fund qeverisjes Austro-Hungareze në Bosnjë dhe Hercegovinë. Në moshën 19 vjeç, në Sarajevë në 28 qershor 1914, ai vrau Arqidukën Franz Ferdinand të Austrisë dhe gruan e tij, Sofi, Dukeshën e Hohenbergut. Principi dhe bashkëpunëtorët e tij u arrestuan dhe u dënuan. Kjo ngjarje i parapriu së ashtuquajturës “Krizë e Korrikut” dhe çoi në shpërthimin e Luftës së Parë Botërore (shën. i përk.).

madh në moshë? Ishte një veprim disi i pazakontë për turqit t'ua merrnin fëmijët prindërve serbë, kur ata s'ishin kaq të vegjël. Turqit nuk harronin t'u kujtonin rekrutëve, kur ata fillonin e stërviteshin për të qenë ushtarë, që të ishin të ndërgjegjshëm për rrënjët e tyre; ata llogaritnin qartë se sa më pak kujtime të kishin nga atdheu i tyre, aq më pak ata do të ishin emocionalisht të lidhur me të.

Dhe, së fundi, ja cila ishte *arsyeja ime* e vërtetë dhe motivi përfundimtar për të filluar shkrimin për Mehmed pashë Sokoloviqin. Kur arrita të studioja gjithçka që mund të gjeja për jetën dhe kohën e këtij njeriu interesant, edhe pse të gjitha këto ende nuk ishin aq të mjafta për të më bindur të filloja të shkruaja (ata dy librat e tjerë të mundshëm ishin ende në lojë), pashë se ku ishte diferenca thelbësore. Më tej, pas të gjithave, për të thënë kështu, gjeta një provë të pamohueshme (dorëshkrime dhe vizatime, komente dhe përskrime nga burime të ndryshme), që diku rreth vitit 1575 Mehmed Pasha kishte ndërtuar në Beograd, mes shumë gjërave të tjera edhe një karvan-saraj<sup>1</sup> të madh dhe një bezistan në të *djathtë, bash nën themelet e ndërtesës, ku unë jetoja prej vitit 2005 dhe ku madje jetoj edhe sot e kësaj dite!* Nga të gjitha vendet, pse tamam pikërisht këtu! Rastësi? Kur them “u ngrit”, mendoj se u ndërtua sipas dëshirave dhe urdhrave të tij, ashtu siç ai vetë e financoi burimin. Kjo quhej patronazh, por në gjuhën e përditshme thuhej “u ngrit”. Ndërtimi ishte realizuar nga Neimar-Mimar<sup>2</sup>, me këtë rast ka të ngjarë të ishte Sinani.

---

<sup>1</sup> Han, tepër modern për kohën, me shumë attribute (shën. i përk.).

<sup>2</sup> Arkitekti (turqisht) (shën. i përk.).

Pas këtij zbulimi, edhe nëse doja apo jo, edhe nëse ishte pretencioze apo jo, fillova të ndieja të pandërprerë thirrjen e brendshme për të shkruar diçka për këta dy njerëz të një trupi të vetëm. Çështja e identitetit të dyfishtë më tërhoqte, në fillim, posaçërisht si një problem i identitetit dhe i religjionit të dyfishtë kombëtar tek *i njëjti* individ. Dhe me hyrjen e Mimar Sinanit te jeta e Sokoloviçit, më duket se ka një mundësi për identitetin *e dyfishtë* të të dy njerëzve. Kështu, identiteti i dyfishtë *i dy njerëzve në një trup të vetëm*, papritmas, do të thotë shumë gjëra. E, është fjala, në ndarjen e qartë të individit bash në dy personalitete, por është edhe e mundur që ngjashmëritë (të paktën dhe të pjesshme) e plota mes këtyre dy njerëzve të shkrihen te një i vetëm!

Tani le të kthehemi tek adresa ime. Themelet e kësaj ndërtese në lagjen “Dorçol” të Beogradit, nisën në fillimin e vitit 1914 (sërisht ajo Lufta e Parë Botërore!) sipas projektit të arkitektit Petar Bajaloviç dhe ndërtesa u mbarua pastaj në vitin 1924 me të ashtuquajturin stil serbo-bizantin me elemente të stilit secesionist vjenez, përndryshe një aplikim i rrallë me kombinime në arkitekturën e Beogradit; ky mund të konsiderohet *vendi nga i cili unë flas*, dyjari në kuptimin e drejtpërdrejtë ashtu edhe në atë simbolik. Nëse do të shtoja këtu kuptimin e shkrimit, të çliruar dhe, ndonjëherë, edhe qëndrimin tim të pacipë, atëherë duhet të shtoja, po ashtu, edhe diçka tjetër. Trashëgimia historike e arkitekturës osmane-islamike, e njëfarë Sinani, nuk ishte e vetmja lidhje në mes së shkuarës dhe të së tashmes. Ka dhe të tjera: për shembull *loja e fjalëve* me *emrat* serbë Bajo/Bajica - veziri i ardhshëm i Turqisë, perandorisë më të fuqishme e në kulmin e saj të fuqisë, në kohën e tij - me mbiemrat

e arkitektit serb Bajaloviq dhe të vetë autorit të këtij libri V. B. (mbiemri i të cilit, pasi u gjermanizua shumë kohë të shkuara nga Maria Tereza në Vojvodinë, ishte më afër mbiemrit Bajaloviq, madje shumë më tepër sesa me vetë emrin Bajica). Atëherë shtëpia ime, e ndërtuar në gjurmët e mbetjeve të kësaj kulture “armike” të kohës dhe me adresën e tanishme në rrugën “Car Dushan”, emri i sundimitarit serb, që mbretëroi në shekullin XIV, i mbiquajtur *I Madhi*, sepse e bëri Serbinë të madhe në histori, e këtu po flasim jo vetëm nga ana territoriale, sepse edhe Sulejmani i Madhërisëm e bëri po kështu Turqinë me ndihmën e zellshme të Bajicas/Mehmed pashë Sokoloviqit dy shekuj më vonë. Andaj, ajo është *ndërtesa nga e cila po flas*, në majën e kulmit të së cilës kishte një shkrim me shkronja të mëdha, në të cilin shkruhej se ajo i takon/te Bashkësisë së Shën Savës (*më të madhit* nga shenjtët serbë dhe figurës shekullore *më të rëndësishme*). Dhe kështu më tej (për shembull, s’kam përmendur konkuistadorin serb, shkrimtarin, që në shekullin XX pushtoi në të gjithë botën, ashtu si thoshte ai vetë, “një armatë lexuesish”, e që në këtë shekull u bë më të vërtetë letrari *më i famshëm* bashkëkohor serb jashtë vendit të tij dhe që po ashtu banonte në të njëjtën adresë ku unë u bëra i njohur).

Historia në përgjithësi favorizon *më të fuqishmit e më të fortët*, dhe gjithë të tjerët që janë “më të mëdhenjtë”. Libri ndërkohë ka një detyrë krejt ndryshe: le të themi të kërkojë, të pyesë nëse ndonjë nga këta *më shumë* në paragrafët paraprijës, ka qenë ndonjëherë në konflikt me këtë, apo nëse e kanë hasur (më shpesh) atë? Dhe, pse? Nëse përgjigja për ndonjërin nga këto është “po”, atëherë libri kërkon si dhe çfarë ndodhi përpara kësaj dhe pas këtij

rrëfimi, e kërkojmë sërish si dhe, ndoshta, edhe psenë e vërtetë. Në këtë rast, madje edhe *emri* i vendit nga ku këto mendime erdhën tek unë, në lagjen “Dorçol” të Beogradit, është me origjinë turke (Dort-jol), që jep mesazh në mënyrë linguistike dhe letrare se ky është (ishte) një vend takimesh, apo mbledhjesh e qëndrimesh, pasi në turqisht nënkuptonte *katër rrugë*, apo më ndryshe: *udhëkryqi*.

Kështu, për ta përmbledhur, *libri* lidhet me mbledhjen e së mundshmes dhe asaj së vërtetës tjetër.

Ndërkaq, *historia* ende mbetet e qëndrueshme, si një monument.



## PËRPARA FUNDIT

Duke e zhvendosur familjen nga Varoshi i vogël drejt vëllait në fshat, i ati mendoi se i shpëtuan kërcënimit turk për t'i degdisur fëmijët e vegjël serbë në vende të ndryshme në Turqi, madje edhe në Oborr, me qëllim për të nxjerrë ushtarë të vërtetë, të zgjedhur për Perandorinë. Megjithatë, nuk mund ta dinte se sanxhakbeu i Hercegovinës, Skënder Ornosoviq, kishte marrë urdhër nga Carigradi, që sipas *devshirme*-së, një herë në disa vite, përreth Bosnjës dhe Hercegovinës “të mblidhte *mijëra* djem të rinj si ‘haraç gjaku’ dhe t’i çonte në Oborr”<sup>1</sup>. Veçse kjo do të thoshte një telash më shumë: duhej të përmbushej një kuotë e tillë me fëmijë të talentuar, që tashmë ishin rritur pas pushtimit të Beogradit më 1521, pasi rrethimi i qytetit kishte shkaktuar humbjen e shumë ushtarëve dhe ndodhi që beut tashmë i nevojitej të mblidhte fëmijë edhe më të rritur, që deri tani s’kishin aq praktikë. Se sa shumë e vështirë ishte kjo detyrë për të, mund të gjykohej edhe prej ngulmit me të cilin ai tashmë as që u kërkonte fare një lloj mirëkuptimi prindërve të tyre, të cilët si gjithmonë i fshihnin fëmijët në pyje, apo ndodhte që qëllimisht edhe i sakatonin pasardhësit e tyre,

---

<sup>1</sup> Në praktikën *devshirme*, merreshin djem me origjinë joturke nga vendet e pushtuara e nëpërmjet një shkollimi intensiv, atje ata stërviteshin të bëheshin trupat elite të ushtrisë turke-jeniçerë, por bëheshin dhe shërbëtorë të Oborrit.

duke menduar se kështu perandoria s'do të kishte nevojë për të tillë njerëz të sakatuar. Agallarët, edhe në këto raste kaq drastike, nuk ndaleshin. Ata, madje, arritën të vizitonin dhe manastiret më të largëta duke hequr nga librat edhe të rinj që ishin përgatitur thjesht për jetë murgërore. Mes tyre ishte dhe Bajo Sokoloviqi, që u mor me forcë nga Manastiri i Mileshevës prej fshatit Sokoloviq, një teolog ortodoks shumë larg të qenët fëmijë, një i ri trupgjatë, gati tetëmbëdhjetë vjeç. Përveç diturisë, nuk kishte as edhe një gjë të vetme që fliste në favor të tij: ai vinte nga një familje fisnike. Fëmijët nga të tilla familje ishin veçmas të dëshiruar për haraçin të pasardhësit (gjakut). Fakti që ai kishte formimin e krishterë të Zotit, nuk përbënte asnjë lloj pengese për osmanët. At Dimitrije kuptoi në një çast se sa shumë i veçantë ishte rasti i tij. Jajabasha kryesor<sup>1</sup>, që quhej Mehmed Beu, i pohoi se ishte dhënë një urdhër special, që Bajica i tij kërkohej veçanërisht për *devshirmenë* e kryeqytetit të Perandorisë. E qetësoi duke i thënë se i biri ishte i destinuar për punë të rëndësishme dhe, ku ta dish, mbase edhe për shumë punë të mëdha, madje i pohoi se prova për këtë ishte fakti se e kishte kërkuar njëfarë Sokoloviq, i cili ishte marrë në të njëjtën mënyrë në sarajet e sulltanit, plot njëzet vjet më parë. Ky njeri tashmë quhej Deli Husrev pasha. Jo shumë kohë pas tij u mor dhe vëllai më i vogël, që tani quhej Mustafa. Husrevi kishte ngjitur shumë shpejt shkallët në Oborrin e sulltanit, duke arritur në një pozicion, ku tashmë, si pasha kishte tagër të merrte po ashtu edhe vendime të rëndësishme.

---

<sup>1</sup> Kapiten (turqisht).

Të gjitha këto ishin arsye bindëse pse babai dhe kushëriri i tij i largët - një murg në Mileshevo - së bashku me primatin e këtij manastiri, Bozhidar Gorazhdanin, nuk mundën ta bindnin një nga agallarët përgjegjës as me lutje, por edhe me paratë që nxorën, për të mos e marrë me vete Bajicën. Së fundmi, atij i duhej të qetësonte veten si prind, sepse të paktën i kishin lënë dy fëmijët më të vegjël. Marrja e njërit prej të bijve e lehtësonte të mos kishte më frikë për të gjitha kohërat: turqit e respektonin fort rregullin e tyre, sipas të cilit vetëm një fëmijë mund të merrej prej një shtëpie.

Kuptohet, se asgjë nuk mund t'ia zvogëlonte dhimbjen e ndarjes. Nëse krahasimi edhe mund të falej, atëherë duhet thënë se ishte shumë e vështirë për Bajicën. Ai ishte i vetmi që po *largohej*, kurse të gjithë të dashurit e tij do të *mbeteshin* larg (ashtu si thuhej dikur në gjuhën e popullit) në të njëjtën “tufë”, kështu që ata do të ishin të paktën pjesërisht të mbrojtur nga pesha e rëndë e vetmisë, që ai po e mbartte me vete, para se të ndahej. Përveç kësaj, i detyruar për të lënë shtëpinë, ai po drejtohej në një vend të *panjohur*, ndërsa e gjithë familja e tij mbeti atje në vendin e saj.

Në udhëtimin e gjatë përmes Serbisë dhe Bullgarisë, ai mundi të mendojë vetëm për ato që kishte lënë pas, apo për gjërat që po e prisnin tashmë përpara. E para e bënte t'ia plaste të qarit, ndërsa e dyta po i ngjallte tmerr.

Krejtësisht i rraskapitur nga vajtimi i pareshtur, që u shndërrua në dënësë, e pastaj në psherëtima të thella dhe me zë, arriti në një pikë që përfundimisht s'kishte më lot, sepse në fakt s'kishte se çfarë të nxirrte më. Tashmë i mbetej vetëm të qante me veten e tij.

Asokohe, nëse ai do ta dinte të paktën se çfarë do ta priste në një pjesë të madhe të ardhshme të jetës, do ta mbante

brenda vetes dhe ndoshta kjo do të kishte qenë më e lehtë! Nëse ai do të kishte thënë publikisht dhe me zë *në fund* të jetës së vet, se e kishte kaluar pjesën më të madhe të jetës me veten - askush nuk do ta kish besuar. Dhe pse duhej: jeta e tij ishte shembull i jetëgjatësisë, megjithëse edhe ajo ishte prerë me përdhunë. Në të njëjtën kohë, jeta e tij ishte kaq publike dhe e rëndësishme, saqë jeta e askujt tjetër nuk mund të krahasohej më me të tijën.

Lëvizjet e sundimitarit ishin aq shumë të dukshme për publikun e gjerë dhe për çdo individ të Perandorisë, saqë nga të dyja anët rregullsia imagjinare dhe ajo reale e të bërit publike të dekretëve, akteve dhe dukjeve të tij, ku bëheshin shpallje, udhëtime, shkohej në luftë, priteshin dinjitarë të lartë, dënoheshin të pabindurit, kishte udhëtime gjuetie dhe Zoti e di se çfarë tjetër, dhe të gjitha krijonin dukjen se veziri i madh nuk kishte kohë të bënte asgjë për veten, e aq më shumë që ndonjëherë të kishte jetën e tij private. Po, natyrisht, dhe ai kishte kohë të mjaftueshme të ishte vetja. Vazhdimësia e punëve të tij publike (nga të cilat, në të vërtetë, një pjesë e madhe kryhej nga aparati servil i Perandorisë dhe jo nga vetë ai personalisht), ku veçanërisht përmendja e emrit të tij në mënyrë të vazhdueshme me këdo dhe për çdo gjë, bënte që ai të dukej çdoherë kur përmendej emri i tij dhe, madje, edhe kur s'gjendej aty, kuptohet, duke krijuar iluzionin se ishte i gjithkundpranishëm. Nëse një gjë e tillë ishte lejuar, ka të ngjarë që disa nga besnikët e tij të afërt do të kishin ndier keqardhje për të, për faktin se kishte kaq shumë gjëra për të bërë. Këtu qëndronin edhe burimet e historive rreth mëdyshjeve të sundimitarit: dukshmëria kaq e lartë e një personi të vetëm thjesht mund të krijohej duke shumëfishuar atë dhe, meqë kjo ishte e pamundur, historitë

mund të shpikeshin, se sunduesi kishte një njeri tjetër në këmbë të tij. Më vonë, arsyet për dukjen e njëkohshme të sundimtarit në disa vende janë zgjeruar, le të themi, për të bërë nga vetë ai shmangien nga atentati.

Kolona e kuajve dhe e njerëzve, që tërhiqeshin dembelisht përballë dhe pas tij në horizont, e ndihmuan të fillonte t'i përmblihte mirë mendimet. Si fillim, kuptohej qartë se ai s'do të kthehej më, të paktën për ca kohë. Arratia ishte pak e mundshme të bëhej dhe, nëse arrinte dhe e bënte, pyetja ishte se ç'do të bënte me këtë lloj shkallë lirie. Mjeshtrit e rinj të fatit të tij e dinin se si ishte puna; ai nuk e kishte mbërritur statusin e tij si një fëmijë i gjetur rastësisht, por ishte një i ri i zgjedhur me kujdes, me një emër, me një mbiemër dhe, madje, edhe me një prejardhje. Ikja e tij drejt Perandorisë Turke madje ishte e porositur! Ai ishte marrë në të vërtetë jashtë vendit, jo për t'u *zhdukur*, por për të *mposhtur* dikë. Ai duhej të ishte i mençur dhe praktik. Nga e gjitha, siç i thoshte i ati, duhej të kapte më të mirën në të gjitha situatat, nëse s'do të përfitonte drejtpërdrejt prej tyre.

Ai po i lutej Zotit të tij që të mos ta braktiste. Lutej që kujtesa e tij, po ashtu, të mos ta tradhtonte. Në këtë çast, “të ishte vetja” do të thoshte “të kujtoje”. Edhe pse, të kujtoje kohën, do të thoshte që kujtimet e tij po rrëshqisnin nga ndërgjegjja në unin e tij fizik dhe tani po ndërtohej një memorie organike, që e bënte atë siç ishte në të vërtetë (tashmë, nga materiali që ishte bërë), duhej të frikësohej nga *harresa*. Ai mendonte se nëse do ta harronte këtë, do të mbaronte së ekzistuari. Nuk e dinte se trupi është i aftë për të lexuar atë që bën, njësoj si edhe mendja. Në atë moment, me qëllim për ta mbrojtur nga e reja, ajo ishte duke lexuar aktualisht përmes të gjithë fëmijërisë, gjuhës, besimit të

tij, prindërve, vëllezërve dhe motrave të tij, qelës së vet të manastirit, dhe të gjitha i ruante në pjesën më të largët të trupit, duke përgatitur mesazhe të kësaj gjuhe për një si lloj letargjie, sado që të zgjaste ajo. Në këtë mënyrë kujtesa e tij mund të zgjaste vërtet.

Ndodhi vërtet që me kalimin e kohës filloi të kuptojë se kush ishin realisht mikpritësit e rinj, mjeshtërit dhe sundimtarët - të gjithë së bashku - e që realisht nuk duhej të shqetësoheshin aq shumë rreth pyetjes: nëse ai dhe fëmijët e tjerë me të, do të harronin apo jo atë që kishin lënë pas. Shpejtësia e ngjarjeve, që e ndoqi, dhe masa e dukshme e angazhimit të ri, do t'ia zgjidhte problemin vetjak me veten e vet.

## KAPITULLI 1

Në shkrimin e një libri, sfondi i të cilit pjesërisht shtrihet në faktologji (historike), gati është e pamundur ta shmangësh, qoftë edhe rastësisht, mistifikimin. Ja, që kur mendova përmes të gjitha rastësive, të cilat ndodhën për shkrimin e këtij libri, më rezultoi se fillova ta shkruaj romanin tim për Mehmed pashë Sokolliun pikërisht në momentin e saktë, i cili shënonte pesëqindvjetorin, që nga lindja e “gjysmës së parë” të tij - e Bajica Sokoloviqit (1505). Mendova me vete se do të isha rastësisht individi i vetëm që kremtoja një përvjetor të tillë kaq të rëndësishëm. Në vendin tim, s’kisha vërejtur nëse ndonjërit nga zyrtarët publikë i kishte rënë në mend (në fakt Natasha Iliq - një gazetare në të përditshmen *Politika* - e përmendi atë në qershor të vitit 2005 në një shkrim të vetin, kryesisht me idenë për t’ua sugjeruar autoriteteve dhe për të apeluar në publik, se *çezma e braktisur e Mehmed Pashës* në Beograd mund të rivihej në punë, por ajo s’ ishte person publik). Dhe e përditshmja *Večernje Novosti* i kushtoi vëmendje jubileut në momentin e fundit, në muajin dhjetor, duke botuar një seri me dhjetë artikuj kushtuar Mehmed Pashës nga pena e Ismet Koçanit.

Duke vizituar, në këtë vit jubilar, për pak kohë Turqinë, nuk e kapa këtë fakt, as atë (as përgjatë vitit, e as në Turqi) që ndokush i kushtoi ndonjë kujdes të veçantë këtij përvjetori. Dukej sikur mua më ishte dhënë mundësia e fundit ta sillja

rastin sido që të mundesha, duke shkruar për të, e jo thjesht për publikun e përgjithshëm (edhe në atë moment), por për veten time. Sepse kur të jetë botuar ky libër, përvjetori s' do jetë më aktual dhe, në fakt, edhe mund të mos ekzistojë më fare. Le të themi, teksa tani po e shkruaj këtë, koha (gati!) ka kaluar. Kështu një mënyrë kremtimi duhej të mbahej nën kontroll, apo të paktën duhej të fshihej nga rastësia, që përbente një kthim fatbardhë të ngjarjeve që u mbuluan nga kremtimi tjetër: ardhja e Vitit të Ri.

Një festim që është kthyer në përkujtim.

Një përvjetor që u zëvendësua nga Viti i Ri.

Mehmed Pasha, i maskuar si Plaku i Vitit të Ri!

Një mundësi e vërtetë, që po dukej si shaka. Një humor cinik i krijuar nga rrethanat, në vend të talentit të shkrimtarit. Ishte njësoj sikur një shkrimtar shkruan pa plan dhe, në fund, gjen si rezultat, për shembull, *një roman pa esencë*.

Pyetja e madhe që shtrohet: çfarë e përbën rastësinë në shkrim? Shkrimtari do të zëvendësojë, do të shpikë, do të zmadhojë, do të shumëfishojë dhe pastaj do të ndajë, do të organizojë, do të marrë hua..., por mbi të gjitha dëshiron të ndërthurë. Dhe kur kjo funksionon, atëherë çdo gjë vërtet bëhet e mundur. Kjo është arsyeja pse fajësia e mundshme për veprat (e këqija) e rastësishme, për të cilat madje as nuk është në dijeni, mund të falet njësoj, si të jetë faji i bërë nga një fëmijë. E para nga të gjitha, sepse ato vepra (të këqija) ndodhin aksidentalisht dhe rastësisht; ato nuk ishin qëllimi, por janë thjesht atje, pa as ndonjë lloj planifikimi. E dyta, sepse rrjedhimet e tyre vështirë se mund të jenë aq dramatike, sa të mund të jenë edhe të riparueshme. Dhe nëse s'janë të riparueshme, ato nuk kanë kurrë ndonjë ndikim aq të gjerë. E treta, sepse ideja bazë ende mbetet në qendër të



vëmendjes - (veprat) e këqija janë thjesht shoqëruese. Dhe, në fund, a ka ndodhur që ndokush ta marrë një shkrimtar seriozisht dhe vetëm për fjalën e tij? Kjo është një arsye tjetër shtesë, nëse nuk është një justifikim, për arsyen pse ai lejohet t'i ndërthurë lehtësisht gjërat. Dhe të mos përgjigjet.

Këtu vjen edhe shembulli i një vepre (të keqe): në kapitujt që janë hamendësuar të lidhen me të tashmen (njësoj si ky), gjatë gjithë kohës, do ta mbaj bashkëbisedimin me vetveten! Është kjo e mirë, apo e keqe? Ndoshta në fund do ta kuptoj realisht si ka qenë, mbase, pos të gjithave, e mirë për librin, edhe pse dyshoj realisht edhe për të në këtë moment. Pse nuk i lejoj heronjtë ta nisin vetë rrugëtimin e tyre, apo si mund të themi, ta zhvillojnë? Mirë, mbase s'është koha e tyre. Dhe nga ana tjetër, ndodhi që jam edhe vetë një nga këta heronjtë (ai me nistoret V. B.). A kam arritur vallë të realizohem si karakter përmes këtij dialogu me vetveten? Vallë, a do të mundë lexuesi të kthjellohet dhe të nxjerrë konkluzione të vërteta për atë (mua)? Dua të them, se lexuesi mund të nxjerrë konkluzione të vërteta. Nëse nuk i nxjerr ai, po kush do të mundej vallë?

## KAPITULLI I

Ata ndaluan në Jederne, Edirne në turqisht, rezidenca e famshme dimërore mbretërore dhe ish-kryeqyteti i vendit.

Pas një pushimi, karvani me numrin më të madh të fëmijëve vazhdoi në drejtim të brendësisë së vendit. Bajica, së bashku me një grup të vogël prej njëqind syresh, u mbajt në Edirne. Bukuria e vendit dhe luksi i jashtëm i karvan-sarajit e pushtoi krejt vëmendjen dhe mendimin e tyre. Gati i harruan të gjitha vështirësitë dhe gjatësinë e madhe të udhëtimit. Para tyre shtrihej sfida e parë e jetës, për të cilën ata s'ishin ende në dijeni, e as nuk arrinin t'ia përshtafnin vetes qartë; tani thjesht po krahasonin vendin nga kishin ardhur me këtë ku erdhën, dhe, për më tepër, nuk kishin madje edhe mundësinë për të parë oborrin e dytë, e aq më pak oborrin e tretë, që ndodhej brenda karvan-sarajit!

Shqisat e tyre ishin mprehur, por askush nuk iu ofroi asgjë.

U përcollën fill në barakat e ushtarëve, menjëherë pranë hapësirës së njësisë që i takonte rojës së sulltanit. Caktuan pak roja për ta - kujdestarë që flisnin gjuhën serbe, por që u adresoheshin atyre me fare pak fjalë, aq sa u lejohej nga detyra: madje, nuk lejoheshin as t'u thoshin gjë privatisht, apo pak a shumë t'u jepnin ndonjë lloj shpjegimi. Secili nga oborrtarët e ardhshëm supozohej se duhej të kuptonte diçka vetë (apo gjithçka, sa të kishte mundësi të përdorte), sa më shumë, që të ishte në gjendje të orientohej.

Në librin e regjistrimit, përveç fakteve ekzistuese, sjellë nga Bosnja dhe Serbia, janë shtuar edhe emrat e rinj turq. Bajo Sokoloviqi u bë Mehmed Sokollu. U urdhëruan që qysh atë çast t'u përgjigjeshin vetëm kur i thërrisnin me emrat e rinj. Ata filluan të mësonin menjëherë turqisht. Mësimet e tyre u mbështetën me themel në mësimin e komunikimit bazë, por ata u kishin futur dhe koncepte, që duhej t'i mësonin fillimisht përmendësh, me shpjegimin se këto gjëra do të sqaroheshin kur të vinte koha, apo kur do të mësonin leximin e *Kuranit*. Orët e gjuhës zhvilloheshin gjatë gjithë ditës dhe ndërpriteshin vetëm kur fillonin ushtrimet fizike, dhe në kohën kur merrej ushqimi i paktë. Para se të binin në gjumë, Bajo e thërriste ende veten Bajica, por kjo nuk do të zgjaste shumë: shpejt ai do të ndihej i rraskapitur, si gjithë të tjerët, dhe do ta zinte menjëherë gjumi.

Muajt e parë kaluan vetëtimthi. Sapo filluan ta zotëronin gjuhën mjaftueshëm e të shpreheshin pa gabime (edhe pa praninë e mësuesve të tyre dhe vëzhguesve, ata ishin të detyruar ta flisnin edhe mes vete), shpejt filluan edhe të lexonin, edhe të shkruanin. Edhe pse ekzistonte qysh herët, shpejt u veçua qartë një grup: ata që provuan se ishin më të mirë u ndanë për të studiuar në fusha të ndryshme shkollimi, me qëllimin t'u futej shpejt dituria, gjerësisht dhe thellësisht. Menjëherë i provuan për gjërat që duhet të mësonin. Ata që nuk ishin të përshtatshëm i grumbulluan në një grup, i cili ishte i përgatitur për pozicionin më të ulët në shërbimin e tyre të ardhshëm. Kur shumë prej tyre u mblodhën në faza të ndryshme të studimeve dhe ata, të cilët s'kishin aq shumë cilësi në ndonjë fushë të caktuar, i rindanë më tej në grupe, nga të cilët kërkoheshin gjithnjë e më pak. Megjithatë, ajo, e vetmja që pa asnjë ndryshim u bë e

përbashkët dhe e qartë për ata të gjithë, ishte se stërvitja e tyre i ishte nënshtruar të njëjtit qëllim - të gjithë duhej t'i shërbenin një dhe vetëm një Zoti. Brenda kësaj kornize, i përshtatën në pozicione të ndryshme, por ato ishin vetëm nuanca në lidhje me nënshtrimin e përbashkët, në verbërinë e nesërme dhe në besnikërinë e unifikuar.

Imami i Edirnes i konvertoi në besimin islam gjatë një ceremonie të përkorë, me një ritual tepër të thjeshtë. Dhe, po ashtu, u bënë edhe synet. Vetëm tani do të ishin të aftë të merrnin religjionin e vërtetë dhe njohuritë spirituale, bashkë me stërvitjen e plotë dhe llojet e ndryshme të përgatitjes ushtarake. Shpejt gjerësia dhe gjatësia e ushtrimeve të tyre luftarake u përshtat me kohën e shpenzuar mbi mësimet e islamit në studimin e *Kuranit* të Shenjtë, shoqëruar edhe me faljet e përbashkëta. Bajica ndihej sikur ata po krijonin tek ai një mbinjeri, të zotin dhe kompetent për të gjitha llojet e shfrytëzimeve të trupit, mendjes dhe shpirtit. Nuk e harxhonte forcën e tij për të bërë rezistencë; e kishte të qartë se përmes kundërshtimit, ai nuk do t'ia dilte të mbrohej prej së pamundshmes. Në këtë mënyrë, të paktën, kishte një lloj ngushëllimi (apo mirazhi) se po merrte pjesë në një vendim që përbënte procesin e pranimit të tij.

Vallë ishte i detyruar, apo e bënte vullnetarisht?

Ishte kjo bash njësoj sikur të mendonte në osmanisht, por të ëndërronte në serbisht. Duke përkthyer kështu vetveten nga një gjuhë në tjetrën dhe anasjelltas, dukej se po përgatiste esencën e tij të vërtetë për të qenë rojë i brendshëm i kufijve, në mes të ëndrrave dhe realitetit. Duke e mbajtur balancën në një fije kaq të hollë, teksa koha po shkonte e gjitha, kjo filloi t'i kujtonte atë aftësinë e pehlivanit mbi litarin e tendosur të pazarit. Me rritjen e lartësisë, po

aq rritej dhe rreziku i rënies dhe, si rrjedhim, ngrihej edhe përfitimi i suksesit të tij të mundshëm. Vallë në të vërtetë këto kontradikta të brendshme s'ishin pamja e së tashmes së tij, por edhe e së ardhmes, dhe kështu - edhe e të gjithë jetës së tij? Zgjidhja ishte tërësisht e kufizuar: ai mund të lejonte rrjedhën ta mbante, apo të përpiqej të ikte jashtë prej saj. Por, si? Dhe, ndoshta, pse? Për çfarë vallë? Pasi këtu nuk kishte shpëtim; heqja dorë nuk do të thoshte se mund të kthehej më në shtëpi. Atë do të mund ta detyronin të jetonte në kushtet më të këqija të mundshme, tamam si të ishte ndonjë rob i zakonshëm, të gjitha mundësitë për ndryshim do të binin, dhe aq më pak për përparim apo sukses. Duke iu bindur vendimit të të tjerëve për të vendosur mbi jetën e tij, ia siguroi edhe vetes mundësinë që po i ofrohej, se kushedi, mbase dikur në të ardhmen, ndoshta, edhe në mënyrë të kufizuar, mund ta ndërmerre përgjegjësinë për të pasur vendime për të njëjtën jetë, këtë herë të tijën.

## KAPITULLI 2

Koha e luftërave, zhvilluar në territorin e ish-atdheut tim, kishte shkuar me shpresën e moskthimit. Por ende jo aq kohë e mjaftueshme për t'u fshehur shumë nga pasojat. Një nga ato, që dukej naive vetëm në vështrim të parë, konsistonte në fenomenin e ri dhe të qëndrueshëm të ndryshimit vulgar të cilësisë së sasisë, për shembull - kthimit të letërsisë në matematikë. Që ta shpjegoj. Qysh në kohën e periudhës së tranzicionit të shoqërive gjysmëprimitive, ajo është nënkuptuar dhe si një përpjekje për të shprehur gjithçka në numra, pastaj edhe si efekt anësor i “krijimit të kapitalit origjinal”, ashtu siç etiketohet nga ata që plaçkitin njerëzit dhe qeveritë, por dhe që spikat si nevojë për t'i dhënë një rend gjithçkaje. Dhe renditja bëhet thjesht - me anë të numrave. Për ata që janë të varur pas parasë, masa e vetme e vlerave janë (ishin) numrat. E, në të vërtetë, toplistat e çdo gjëje që ekziston sot janë krijuar kështu. Çfarëdolloj subjekti, që të shkon ndër mend, do ta përshkruani në termat e krahasimit të renditjes së tij në *lidhje me diçka tjetër* që ke zgjedhur.

Kështu edhe në botimet letrare, u shfaqën numra të të gjitha llojeve. Shumë nga ata duken të tepërt, kur rrethohen nga fjalët. Përveç ndoshta shifrave që shprehin të ashtuquajturin tirazh, apo kopjet e librave të shtypur dhe të numrave të redaktimeve për një titull të veçantë. Të tilla shifra kanë qenë gjithnjë këtu, por kur ato janë

vërtet të rëndësishme për t'u botuar, ato s'do të ishin kurrë vendimtare, të pandryshueshme apo hyjnore. Thjesht ishin atje, si një pjesë e njëjtë e së tërës, së krijuar nga elemente të ndryshme, përfshirë edhe numrat që bënin librin dhe jetën e tij.

Megjithatë, këta numra të tjerë, të cilët na u shfaqën pas tranzicionit, ishin të tepërt: për shembull, numrin që shënon vendin *që zë* një libër, nxjerrë në toplistën më të njohur, më të shitur, më të lexuar, më moderne e kështu me radhë... Në sipërfaqe, *zënia* e vendit të një libri përmes një metode demokratike. Por kjo ishte iluzion. Ndjenja ishte e parëzistueshme që tranzitimi ka qenë i realizuar përmes përdorimit të numrave, pra me anë të *kapjes* së vendeve.

Dhe matjet nuk kishin fund: për sa javë një libër do të gjendej në toplistë, sa botime do kishte me kopertinë të hollë, të kthyer, nga ato me kopertinë të arta, kopertinat absurde, që mbaronin me mbulimin e syve të lexuesit. Dhe, më tej, cilin vend do të mbante një javë më parë, sa javë do të vazhdonte, sa vota kishte marrë dhe nëse votimi ishte bërë elektronikisht - sa shumë "vizita" ishin realizuar në *website*-t e votimeve. Pastaj krahasimet: të gjitha të dhënat e një libri, të përkthyer nga një gjuhë, krahasuar me numrat e vendeve të tjera. Pastaj, sërish.

Ka, po ashtu, edhe numra të fshehur, që kurrë s'e arrijnë publikun: marrëveshje, kontrata detyrimi, *afatin* për shkrimtarët që të dorëzonin dorëshkrimet, sa faqe do të duhej apo mund të shkruante (as më shumë e as më pak), përqindja e përfitimeve në të gjitha rrethanat e mundshme për çdo faqe të kontratës, dhe kjo do të thoshte njësoj si për shkrimtarin, ashtu edhe për botuesin. E parashikuar ishte edhe çfarë mund të ndodhte në rrethana të paparashikuara.

Mospërmbushja e pikave të detyrimeve të kontratave të tilla, mund të shprehej gjithashtu me numra: që nga pikët ndëshkuese, deri në humbjet e përqindjeve. Kjo lloj matematike dukej madje më e fortë se vetë vdekja! Shtatëdhjetë vjet pas vdekjes së autorit, llogaritja mbetet e njëjtë: çdo gjë vazhdon të llogaritet, shtohet, hiqet, shumëfishohet dhe ndahet. Është fat që librat e kalojnë jetën e shkrimtarëve të tyre, por llogaritjet nuk mbarojnë: ato e ndjekin autorin dhe në botën tjetër dhe nuk e lejojnë t’i anulojë të drejtat e tij. Kjo pjesë *post mortem* e kohës është quajtur *matematika e lumtur*.

Polemika *për* dhe *kundër* kësaj, dhe gjithë kësaj lloj martese ndërmjet letërsisë dhe matematikës nuk e ka arritur ende kulmin. Arsyeja është e thjeshtë, por nuk është ende e dukshme. Kryesisht në tranzicion, intelektualët humbin rëndësinë e tyre shoqërore dhe kulturore, që i kap dhe pastaj i bën konfuz, i degradon dhe gati i bën të marginalizuar. Për gjithë këtë ndryshim statusi, dhe nga ish-shfaqja e tyre shtohet edhe një varfëri materiale e re dhe mizore. Në një gjendje të tillë, paradepresive, disa njerëz në botën e letërsisë dhe asaj të botimit bëhen moralisht dhe materialisht të korruptueshëm. Në mënyrë popullore, ata quhen “matematikë”.

Ndoshta, e gjithë kjo nuk ishte kaq tragjike, pasi nuk shkaktoi ndonjë ndryshim në tiparet individuale dhe pjesë të karakterit të tyre. Kjo pavarësi e re e krijuar, kombinuar edhe me çështjen e kombit, përkatësisë etnike, çështjet gjuhësore, si edhe të ngjashme me to, i bën intelektualët, që kurdo dhe gjithmonë, të shkojnë te problemi i identitetit. Dhe kur mbërrijnë në këtë pikë: ja shkatërrimi dhe ndërtimi, pastaj ndërtimi dhe shkatërrimi. Për identitetin. Dhe për çdo gjë tjetër.



## KAPITULLI II

Artet marcialle mund të jenë dhe një maskë për shumë nga gjërat e tjera, të cilat janë të mposhtura: veçse në pamjen e asaj që duket thjesht dhe krejt si një shkollë mizore e përballjes fizike, përfitoheshin shumë aftësi shpirtërore. Për shembull, me qëllim që të pranohej edhe guximi si pjesë e kurajës së tij, fillimisht mund të interpretonte frikacakun; kjo vinte fill pasi ai e pushtonte këtë në ndërgjegje, dhe pastaj i afrohej mësimi se si të lirohej prej saj. Atë çast ai do të guxonte ta quante këtë gjendje të re si pjesë të personalitetit të tij.

Në përgjithësi, momenti kryesor i të gjithë përgatitjes ishte kuptueshmëria mes trupit dhe shpirtit. Sapo ai e realizoi lidhjen, ishte më e lehtë dhe e shpejtë për të krijuar vlera. Ky ishte një rrjedhim natyral. Raporti reciprok i frikës dhe i kurajës, për shembull, rezultonte në kuptueshmërinë e vartësisë dhe super urdhrit. Frika trajtohej përmes shprehjes së sfidës, por... mësuesit e tyre atëkohë i ngrinin ata në një fazë më të lartë të depërtimit në barrierat psikologjike - ata pretendonin se nga frika mund të prodhohej dhe kuraja. Dhe kjo mund të ishte edhe më e egër, dhe më e madhe sesa zakonisht! Duke u futur në këto procese, dhe me shembujt e tyre, provuan saktësinë e të tilla mësimëve.

Këto ishin mënyrat për ta kuptuar qëllimin në mënyrë më korrekte: duhej që nga ai të mos bënin një qenie mbinjerëzore (ashtu si mendonte në fillim), duke i implementuar diçka

të huaj, por të sillnin në sipërfaqe atë që ai kishte vetë thellësisht brenda, dhe të arrinin ta përdornin me sa më shumë efikasitet dhe shterim që të ishte e mundur. Njësoj sikur do të donin ta riformatonin drejt një njeriu të ri të plotësuar.

Në të vërtetë, kjo e fundit u bë fare e qartë vetëm për Bajicën dhe për pak nga të rinjtë e grupit. Askush s'kishte pse t'u thoshte se ishin të paracaktuar për detyra të posaçme; pasi ata ndiqnin shumë nga mësimet veçmas, pa djemtë e tjerë. Megjithatë, si rrjedhim i kësaj ndarjeje, pas kaq shumë kohësh të kaluara bashkë, kuptohet dhe prej ndjenjës së fortë të sigurisë në bashkësi, mes disa syresh filloi të zhvillohej një miqësi e çuditshme, pak edhe si shpenguese, një lloj miqësie e re; që në fakt ishte pak e fshehtë, ngaqë nuk mund ta shpërfaqnin dot hapur. Kjo vazhdoi deri para një momenti të veçantë.

Bajica as edhe pas disa vjetësh qëndrimi në sarajin në Edirne, s'ia doli të shihte eprorin e tij. Sulltani ishte i zënë me punë dhe në hapësira të tjera. Edhe kur vinte në Edirne, ndërkohë, sunduesi nuk do t'i shikonte, pasi kur tërhiqej në karvan-saraj, të gjithë djemtë mbylleshin në dhomat e stërvitjes dhe ruheshin nën kontroll të fortë, aq sa askush prej tyre, qoftë edhe rastësisht, nuk do të arrinte të shihte jashtë. Sulltani, me sa e informonin, ishte gjithmonë i mirinformuar për avancimin e ruajtësve të ardhshëm të Perandorisë, sepse ishte shumë serioz dhe në mënyrë të vazhdueshme i interesuar për të ardhmen e tyre. Provë e kësaj ishte kur një ditë, në oborr, u shfaq papritur emisari i tij, Deli Husrev Pasha. Ishte i vetmi, që u lejohej ta shihnin.

Për këtë mysafir, dhe mikpritës në të njëjtën kohë, ishte organizuar menjëherë prezantimi publik i aftësive dhe

njohurive të të gjithë rekrutëve të rinj, duke mbajtur veshjet e zakonshme në përputhje me protokollin zyrtar, shoqëruar kjo edhe me një ceremoni të plotë. Ata e mrekulluan me njohuritë e historisë në persisht dhe në arabisht, dhe nga recitimi i shumë sureve të mësuara për shfaqjen e Zotit të Muhamedi.

Pashai u mbajti një fjalim të gjatë në fund, ndërsa ata qëndronin para tij. Dhe, atëherë, duke i shpërndarë nxënësit e tjerë, ftoi dhjetë prej tyre, që ishin më të mirët, të vinin në dhomat e brendshme të karvan-sarajt, me fjalët se e meritonin t'i shihnin odat e sulltanit. Kur ata ndaluan në një mjedis, që aktualisht dukej se ishte i rëndësishëm, për shkak të mungesës së pajisjeve dhe zbukurimeve të tepërta, pashai u tha:

“Kur mjeshtri ynë mbledh vezirët në Edirne, ky vend mban Divanin perandorak që mbledhet për të vendosur problemet e rëndësishme të shtetit. Dhe aty sipër, në majë të këtij muri, në të djathtë të tavanit, ku shquhet ajo dritarja e fshehur, pas perdes së tij ulet vetë Sulltani, që dëgjon nga sipër se si punojnë vezirët e tij”.

“Njësoj si Allahu që na vëzhgon ne nga sipër”, - kërceu Bajica. Shumica e shokëve të tij e panë me habi; disa me bezdi, të tjerët duke e aprovuar.

Dhe, atëherë, do të vinin disa surpriza të vërteta. Deli Husrev Pasha nxori fillimisht të gjithë shoqëruesit dhe rojat e djemve dhe, kur të gjithë ata u larguan në oborrin e jashtëm, foli drejtpërdrejt në serbisht:

“Keni treguar se jeni nxënës të mirë të Perandorisë. Kur kënaqësinë time do t'ia përcjell sunduesit tonë, kjo do të thotë se të gjithë do të shpërndaheni shpejt në drejtime të ndryshme, bazuar në informacionin e gjerë të mësuesve dhe

mbikëqyrësve tuaj, që do të jepet për secilin prej jush. Do të caktoheni në detyra të ndryshme, në pjesë të ndryshme të botës”.

Pasoi një pauzë.

Atëherë iu afrua njërit prej shokëve të Bajicës, që njihej tani si Mustafa, dhe papritmas e përqafoi, dhe i tha me dhembshuri:

“Vëlla”.

Djali shtangu, duke mos e pritur atë që ndodhi, i frikësuar se nuk e kishte dëgjuar mirë pashain. Pashai i mërmëriti diçka për disa momente në vesh dhe, pasi e kapi nga shpatullat Bajicën, i pëshpëriti edhe atij në vesh:

“Ai është vëllai im, por është edhe kushëriri yt”.

Pas kësaj iu adresua dhe një herë grupit:

“E keni të qartë tani se jam një nga njerëzit tuaj. Më kanë sjellë këtu njësoj si ju, plot njëzet vjet më parë nga Hercegovina. Jam nga familja Sokoloviq dhe unë kam sjellë këtu disa prej jush. Tani po e shoh për herë të parë vëllain tim të vogël, që kur ka lindur. A s’është kjo e çuditshme dhe e mrekullueshme?”.

Mustafai pa nga ai, sytë dhe goja i kishin mbetur krejt të hapura. Bajica po e shikonte me të njëjtën habi. Po dëgjonte nga këto buzë, pas gjithë kësaj kohe, mbiemrin e tyre jo të harruar, veçse tashmë krejt të zëvendësuar!

E gjithë historia e pashait, me aq sa kuptuan, kishte si qëllim t’i trimëronte e të mos tërhiqeshin nga ky rast, që u ishte dhënë, të mësonin për arsimim më të mirë të mundshëm, të përdornin çfarë u ishte ofruar për të shkuar sa më lart që të mundeshin e, kur të vinte koha e tyre, edhe t’i përdornin të gjitha ato për të arritur qëllimet - çfarëdo që mund të ishin dhe kurdo qoftë t’u jepej rasti. Ai u ofroi një

masë intimiteti, i prekur nga prania e tyre dhe me ndjenjat e trullosura. U përpoq të ishte i qartë, por edhe u kujdes të mos ishte shumë i hapur. Nuk kishte pse t'u thoshte atë që ata e kishin kuptuar tashmë: pra, sa të mundeshin duhet të ndihmonin dhe të mbështesnin njëri-tjetrin, duke përdorur çdo mundësi që do t'u jepej. E se ata nuk duhet të harronin kurrë nga kishin ardhur, por edhe që s'duhet të dështonin kurrë për atë që i priste. Nëse për ata ishte gjykuar t'u jepej një e shkuar dhe një e ardhme tjetër, duhet të krijonin dhe të ruanin diçka që, si në rrugë sekrete apo krejt hapur, i bënte plotësisht të ndryshëm nga të tjerët. Vetëm në këtë mënyrë, do të ishin të aftë të ruanin paqen brenda tyre dhe me veten. Sepse dhe e theksoi këtë: nëse ata nuk do të ishin të ndërgjegjshëm për dualitetin në të cilin ishin hedhur, kurrë s'do të ishin të aftë të përballonin qoftë edhe një nga sikletet e vetme me të cilën do të haseshin.

“Kushdo që ia del të ngrihet mbi dualitetin e tij, do ta kthejë fatin e keq në avantazhin e vet. Të mos kesh asnjë nga prindërit, është vërtet një tragjedi. T'i kesh të dy është një gëzim i madh, por këtë veç duhet ta kujtoni çdo ditë. Ndoshta tani ju duket se jeni pa prindërit, por shumë shpejt do t'i shikoni se i keni të dy.”

Pashai e ndihmoi Bajicën të formonte diturinë e parë rinore: nëse diçka nuk mund të shmanget, atëherë ajo duhet të përballlet.

Dhe, një rrjedhim i çuditshëm i vizitës së Deli Husrev pashës u demonstrua para tyre lehtësisht dhe krejt hapur: pas ikjes së tij, ky grup i zgjedhur djemsh filloi të flasë serbisht mes njëri-tjetrit, duke respektuar ligjin e tyre të pafolur; se këtë do ta bënin gjithmonë jashtë stërvitjes dhe nuk do ta fshihnin më. Dhe vetëm të imagjinosh! Askush

nuk kundërshtoi dhe sigurisht që askush s'u përpoq më gjatë të mos e bënte atë! E, pse do ta bënin tekefundit! Koha po vinte në mënyrë të paevitueshme dhe ata e dinin këtë shumë mirë, se do të shpërndareshin dhe e kuptonin qartë se nuk do të mundeshin të flisnin më serbisht, përpos vetes. Kështu që kjo ishte diçka që sigurisht nuk i dëmtonte.

### KAPITULLI 3

Nuk më pëlqen në të vërtetë përcaktimi i çdo gjëje (vetëm të kujtosh numrin e tepërt të përdorimit të kësaj fjale, që përmendet aq shpesh në të gjithë shkollimin tonë). Gjithmonë me temën e shkrirjes së letërsisë me *matematikën* (një tjetër fjalë shkolle, që i përcjell fëmijët e vegjël në shumë sfera të veprimeve me numrat), më dha një nevojë të parëzistueshme të përcaktoja paranë. Dhe ja ku arrita në përfundimin: paraja është një vlerë e shprehur në numra! Shihet qartë se deri te një konkluzion i tillë nuk duhet edhe aq shumë inteligjencë. Vallë për këtë s'mund të thoshim të njëjtën gjë, për shembull, për kohën: Vitet janë një vlerë e shprehur në numra. Ha! Saktësisht, ashtu si shumë gjëra të tjera që mund të shprehen me të njëjtin përcaktim të saktë. Por s'është kjo ajo që mendoj. Nëse është e vërtetë, që kjo "dituri" mund të aplikohet në shumë koncepte dhe fenomene të tjera, kjo nuk do të thotë se përcaktimi origjinal nuk është korrekt, e as se edhe e anulon ekzistencën e gjërave.

Çfarë dua të them me këtë? Mirë, ja që vlera nuk mund të barazohet me cilësinë. Kështu që ka një kuptim të ndryshëm në pohimin e bërë se "paraja është një vlerë e shprehur në numra" dhe "paraja është një cilësi e shprehur në numra". Tani kemi arritur në të ashtuquajturin thelbi i çështjes: imagjinoni kur disa lloj shkrimtarësh japin dhe barazojnë sistemin e vlerave, të shprehur në numra (vendi ku janë librat e tyre në toplistë, le të themi), me cilësinë e

librave të tyre. Ju nuk do ta kuptoni se kush do ta ketë më të vështirë për të falur: krenaria e shkrimtarit, apo krijuesit e këtyre fabrikimeve monstruoze - toplistat.

Të tilla fenomene nuk do të ishin shqetësuese, nëse do të mbeteshin thjesht në nivelin e fenomenit. Ato janë, megjithatë, shumë më tepër se kaq, teksa në fillim janë vetëm një trill dhe një tendencë, por me kohë, ato kthehen në planin e vërtetë, në program, të gjitha me qëllimin e kthimit në sundim dhe zakon. Kjo është arsyeja pse ato s'mund të quhen të rastësishme, joserioze, ose thjesht jetëshkurtra. Qëllimi i tyre është të bëhen dhe të mbeten një vlerë e madhe. Numri është i barabartë me cilësinë.

Por, si duket kjo në praktikë? Dikur ndodhi të isha vetë i pranishëm, ta themi fjalë për fjalë, në leximin e një referati të një autoreje shumë popullore, e cila i mbronte numrat. Me qëllimin për të na provuar se vendi i saj i parë te librat më të lexuar ishte i pakundërshtueshëm në çdolloj këndvështrimi dhe ku në të vërtetë nuk e sfidoi në njëfarë mënyre askush, ajo e krahasoi vetveten me shkrimtarët më të mirë, të zgjuar dhe më të rëndësishëm të shekullit! Natyrisht në ego-kërkimin e saj nuk kërkonte, apo nuk donte të gjente, as edhe ndonjë numër që i korrespondonte, për shembull, vendeve të mbajtura nga librat e atyre shkrimtarëve të respektuar në toplistat e kohës apo të historisë. Kuptohet se ajo nuk mund t'i gjente, sepse në kohë të tilla listat as që ekzistonin, pasi kuptohet se nuk ishin aspak të nevojshme. Shkrimtarët i kapnin pozicionet e tyre bazuar në merita dhe nuk kishin pse shënoheshin në mënyrë numerike. Mesazhi im ishte i qartë. Zonja shkrimtare ishte ofenduar, sepse pak më parë dikush publikisht kishte guxuar ta sfidonte pretendimin e saj, se vendi i parë ishte, gjithashtu, edhe vendi i më të



miri. Ajo ngatërronte këtë formulë me një tjetër, disi më joshëse: se vendi i parë ishte, gjithashtu vendi më i mirë.

Dhe për të mos pasur as edhe një dyshim të vetëm: vendi i parë mund të jetë vërtet vendi më i mirë, por ai në asnjë mënyrë nuk do të thotë se ky është vendi që i takon më të miri.

### KAPITULLI III

Disa muaj më vonë, pasoja më e madhe dhe më e rëndësishme e vizitës së pashait, u kuptua se na kishte qenë vizitë spiunazhi; ishte ardhja e vetë madhërisë së tij. Por, tashmë jo thjesht në karvan-sarajin e vet, por drejt e në mes të djelmoshave të “haraçit të gjakut”. Këtë herë do të ishte më korrekte, të themi, se ata u lejuan të qëndronin para sulltanit të madh. Zemërgjerësia e tij arriti me durimin që ta këqyrte vetë grupin qartësisht, ta tundte dorën me shenjën që tregonte se duhet të qëndronin të qetë dhe të uleshin në divan; e madje lejoi dhjetë prej tyre t’i prezantoheshin vetë. Fillimisht u bë nga mësuesi i tyre aga, që qëndronte në të djathtë dhe Deli Husrev pashai, si njeriu i eskortës së sulltanit, ose më saktësisht njeriu që gëzonte besimin e veçantë të tij.

Pashai foli me vetëbesimin e tij të padepërtueshëm rreth secilit prej djemve, individualisht: nga kishte ardhur, nga cila dhe çfarë lloj familjeje vinte, gjërat për të cilat kishte treguar talent të veçantë gjatë mësimeve dhe ku, sipas opinionit të tij, duhet të vazhdonte shkollimin dhe shërbimin e tij. Kështu, përballë sulltanit, Bajica zbuloi se fati i tij ishte planifikuar të ishte ngushtësisht i lidhur me sunduesin suprem: sarajin perandorak në Stamboll!

Për një dekokë pati shansin të rrokte shikimin e sulltanit mbi të - që e ngriu mu në vend. Tek ai shikim pa një kombinim të çuditshëm të letargjisë me interesin, por mbi

të gjitha, një ftohtësi të akullt, që kishte të ngjarë të vinte nga shtrirja e madhe e fuqisë së tij në marrjen e vendimeve të mëdha: që nga çështjet e fateve të vogla të njerëzve, deri në modelimin e së ardhmes së fiseve dhe shteteve të tëra. E sërish, ushtari që strehohej tek ai nuk ishte aq i përfjetur, saqë të mos tregonte interes mbi këta skllavër të edukuar, prej të cilëve nesër ndoshta mund të varej edhe vetë jeta e tij. Bajica u mësua se të gjithë fëmijët e sjellë këtu, nga nivele të ndryshme detyrash, që nga ushtarët jeniçerë të këshilltarët e lartë të ardhshëm të perandorit, secili dhe çdokush prej tyre kishte një rol të merituar dhe identik, që lidhej drejt me sulltanin: ai do të mundej të shkonte drejt një posti të madh, apo më të vogël, në varësi nga sesi dhe kur sulltani do të gjendej afër tij, duke pasur më shumë besim tek ata sesa në formacionet e tjera ushtarake. Jeta e tij do të varej në besnikërinë e tyre ndaj tij, qoftë individuale dhe kolektive. Po kështu dhe jetët e tyre. Ata do të ishin mburoja e tij kundër gjithë të tjerëve: si nga ata jashtë dhe nga ata brenda perandorisë. Dhe ai do ishte mbrojtësi i vërtetë i tyre.

Për të gjitha këto do të mendonte në ditët që vazhduan, pasi mbaroi çdo gjë. Ende mbi të gjitha konkluzionet e dukshme, ishte njëra që rrinte pezull dhe që ishte më e thjeshta, por edhe më e rëndësishmja për të: ai, Bajica, nuk ishte më i fshehur ndaj perandorit! Kështu, ai e dinte tashmë se nënkuptonte diçka për ta. Kjo përbënte një njohje më shumë për pranimin e tij si i huaj. Në shkëmbim të këtij pranimi, atij i është thënë se do të kishte privilegje në të ardhmen dhe jo mallkimin e skllavit, nga i cili askush nuk do të mundej t'ia hiqte dot statusin, madje edhe vetë sulltani.

Në fakt, tashmë po i afrohej rasti të ishte vetë një skllav perfekt.

## KAPITULLI 4

Numrat që përdoren në letërsi dhe në libra, ngandonjëherë marrin karakteristika humoristike, por shkaktojnë pasoja absurde. Te një panair lokal librash, i zhvilluar kohë më parë, organizatori publikoi në të gjitha mediat një listë të të gjithë pjesëmarrësve. Kishte shumë gjëra të shkruara në këtë mesazh zyrtar, por e vetmja gjë që mungonte ishte kriteri i përdorur për të renditur botuesit, bash ajo që i bënte ata më të mirë ose më të këqij sesa të tjerë syresh. Ishin disa *më të shumtë*, por nuk dihej se për çfarë arsye. Dhe atëherë, pas një analize serioze dhe kërkimi për arsyet për mosthënien e kritereve kryesore, që ishte përjashtimi i harresës së organizatorëve, u bë e qartë se ky detaj nuk ishte aq i rëndësishëm për sa kohë e përbënin më të shumtët.

Erdhi koha, apo mbërriti momenti për mua ta citoj vetveten, ashtu si në fillim të këtij libri (në kapitullin e titulluar *Pas fillimit*) në paragrafin, ku unë përmend epitetet, që u bënë pjesë e emërimit të njerëzve sipas fuqisë apo madhësisë së tyre: i Madhi, i Madhërishti apo, nëse do të përdorja caktimet e zakonshme - më i madhi, më i rëndësishmi, më i famshmi. Por, pse vallë? E po, me qëllimin për të rrëfyer se si historia shpesh ka qenë Estradë popullore, ja citimi këtu për të: “Historia do veçanërisht *më të madhin, më të fortin, më të fuqishmin, dhe çdo gjë më të shumtë*. Ky libër ka detyra të ndryshme...”.

Kjo është arsyeja pse ky libër mbetet në korniza, mbi hulli, ndërsa historia lejon vlerat e përjetshme të renditjes

popullore për t'u vendosur përgjatë monumenteve të saj të ftohta dhe të denja. Estrada<sup>1</sup> është dinake, ngaqë përdor dobësinë e historisë në drejtim të të gjitha llojeve të triumfuesve (madje edhe para atyre më të gënjeshtërtë, jo të rëndësishme dhe atyre groteske...), e kështu lehtësisht futet nën lëkurë. I pëshpërit komplimente historisë në mënyrë që t'ia fitojë zemrën. Dhe sharmi është pjesë e vendit nga i cili flet dikush: në të ashtuquajturat arte popullore të zbavitjes (më shpesh “artet”), ai vend quhet podium, kurse në veprimin e aktivitetit politik - thjesht skenë.

Do të ishte procesi i shndërrimit individual social dhe ekonomik i shteteve europiane, që do të na tregonte ngjashmërinë e rrezikshme në mes të politikave (si histori e së ardhshmes) dhe aftësive popullore të estradës (si të përjetshme tani). Kjo ngjashmëri provon, paraqet dhe na përcjell deri në nivelin e paturpësisë perfekte, apo të një perfeksioni të pacipë, njësoj, që u provua të jetë një bashkim ideal i forcave kundër librave. Frika e pohimit të imazhit për zgjatjen e përjetshme të librit, apo të paktën peshës së saj natyrale drejt një ekzistence të gjatë, por shpesh edhe me suksesin e saj po aq, e ka ngurtësuar këtë imazh primitiv si karikaturë, disi absurd, por gjithashtu një simbiozë e rrezikshme në një martesë të pathyeshme

---

<sup>1</sup> Në serbisht fjala estrada (këtu përkthehet “Faza Popullore”), veçanërisht që nga fillimi i viteve 1990, pati një konotacion poshtërues, që do të thotë muzika e folkut të ri të pavlerë, si edhe artet e tjera të performancës, që sundonin në këtë periudhë, ato që i miklonin audiencat me anë të nxjerrjes së më të ultës në estetikë dhe në nxitjet e tjera. Ata e prezantojnë vetveten në mënyrë false si folk-art, duke përdorur të vërtetën e mjegullt se rrënjët e tyre të largëta mund të gjenden në etnosin kombëtar.

të përshtatshmërisë. Motoja është sajuar shpejt, si forcat e ndërhyrjes së shpejtë, të tipit populizëm kundër elitizmit. Dhe që kur nënkuptohet për një numër të vogël njerëzish, atëherë ajo punon kundër demokracisë, e cila shkon pa thënë e nënkuptuar të paktën për një numër të madh njerëzish. Ja pra - dialektika kalimtare!

Fakti që në trashëgiminë botërore ka libra që na arrijnë në të tashmen nga një e shkuar e largët, apo shumë më e largët, dhe është tërësisht e vërtetë që do të mbijetojnë edhe në të ardhmen e shpejtë, apo dhe më të largët, vetëm sa e ngurtëson pozicionimin e sulmuesit dhe qëndresën.

Lufta mes përzgjatimit të ditës, dhe madje edhe asaj pak më të gjatë syresh, shndërrohet në një luftë të zhurmës mbi qetësinë (e fundit është krijuar për shkak të arsimimit në shtëpi dhe jo për shkak të frikës); zëri i fshehtësisë kundër zërit publik, i ofendimit kundër tolerancës, i agresivitetit kundër të zakonshmes, i luftës kundër paqes.

Kush do të fitojë vallë? E po, dihet, triumfuesit.

Me shpresë këtë e kemi mësuar shumë tani.